# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6866
E martë, 4 prill 2023
çmimi 0.40 €


## Rama do ta nisë podcastin: Flasim edhe me kundërshtarë, të ftuar politikanë e artistë FAQE 2



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ME FJALËN HYRËSE TË PROKURORISË KA NISUR GJYKIMI NDAJ THAÇIT, VESELIT, SELIMIT DHE KRASNIQIT FAQE 4-5

# LIDERËT E UÇK-së DEKLAROHEN TË PAFAJSHËM



Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi janë deklaruar të pafajshëm në nisjen e procesit gjyqësor kundër tyre në Gjykatën Speciale. Ata kanë thënë se asnjë nga pikat e aktakuzës nuk qëndrojnë. Ndërsa ZPS-ja në fjalën hyrëse ka paraqitur argumentet e saj në raport me aktakuzën kundër katër drejtuesve të UÇK-së. Procesi gjyqësor ndaj katërshes së UÇK-së do të vazhdojë edhe sot (e martë). Mbrojtja e Thaçit do ta paraqesë fjalën hyrëse

"LIRIA KA EMËR" FALËNDERON TË GJITHË ATA QË KONTRIBUUAN NË "MARSHIN PËR DREJTËSI"

## HOXHA E TASHOLLI: KY ISHTE MARSHI I DINJITETIT QYTETAR

Ideatorët e platformës "Liria ka emër", Eliza Hoxha dhe Ismail Tasholli, kanë mbajtur të hënën një konferencë për medie, në të cilën kanë falënderuar të gjithë ata që kontribuuan në realizimin dhe mbarëvajtjen e "Marshit për drejtësi" për ish-krerët e UÇK-së në Hagë. Ata theksuan se "Marshi për drejtësi" ishte "marshi i dinjitetit qytetar"




## AKTUALE



### BE-ja shpreson se ngjarjet në veri nuk do të ndikojnë në takimin Bislimi - Petkoviq F. 7

### Të enjten Kuvendi mban seancë plenare F. 6

### Vdes një punëtor i Kompleksit Metalurgjik "Trepça" F. 6

## EKONOMI



### Punëtorët në grevë, Bordi i KEK-ut shprehet i hapur për dialog F. 8

### Punësimi më i lartë te burrat/djemtë 46.6 për qind, te gratë/vajzat 17.9 për qind F. 8

## SPORT



### Skitarja Sophie Sorschag pranoi dekretin shtetëror për ta përfaqësuar Kosovën F. 6

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

# BE-ja e gatshme të punojë me presidentin e ri të Malit të Zi

BRUKSEL, 3 PRILL - Bashkimi Evropian ka shprehur gatishmëri për të punuar me presidentin e ri të zgjedhur të Malit të Zi, Jakov Millatoviq, duke shprehur bindjen se ky shtet do të mbetet i përkushtuar për rrugën evropiane. Në të njëjtën kohë, Brukseli ka bërë ftesë për stabilitet politik në këtë shtet në mënyrë që të përshpejtohet procesi i reformave dhe të arrihet përparim në negociatat e anëtarësimit. Kështu tha të hënën në Bruksel zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, kur u pyet për rezultatin e zgjedhjeve në Podgoricë.



Kandidati për president të Malit të Zi, Jakov Millatoviq, ka fituar rreth 60 për qind të votave në raundin e dytë të zgjedhjeve presidenciale të dielën, kurse kundërkandidati i tij, presidenti aktual Millo Gjukanoviq, ka marrë rreth 40 për qind, treguan rezultatet preliminare. "BE-ja do t'i japë vlerësimet e veta zyrtare pasi të bëhet publik raporti i Misionit të BE-së për Vëzhgim të Zgjedhjeve. Në përgjithësi presim të bashkëpunojmë me presidentin e ri dhe me të gjithë partnerët politikë në Podgoricë për t'i ndihmuar Malit të Zi të mbetet fuqishëm në rrugën e integrimeve evropiane. Prioritete duhet të jenë sundimi i ligjit dhe vazhdimi i reformave në drejtësi ashtu siç është kërkuar nga raportet përkatëse të Komisionit Evropian", tha Stano.

Analistët thonë se është ende e paqartë nëse Millatoviqi dhe partia e tij në rritje "Evropa tani" do të vazhdojnë t'i ndjekin politikat pro Bashkimit Evropian. Ata paralajmërojnë se marka e populizmit e kësaj partie mund të shkaktojë lëkundje përballë çështjeve të vështira me të cilat përballet një nga demokracitë më të reja të kontinentit, përfshirë këtu: ndarjet politike mbi identitetin serb dhe malazez, marrëdhëniet me Beogradin dhe Kishën Ortodokse Serbe si dhe ndikimin rus në rajon.

# Ukraina thotë se forcat ruse janë "shumë larg" nga kapja e Bahmutit



KIEV, 3 PRILL - Ukraina ka njoftuar më 3 prill se forcat ruse ishin "shumë larg" nga kapja e qytetit lindor të Bahmutit dhe se beteja ishte rreth ndërtesës së administratës së qytetit, ku grupi mercenar Wagner pretendoi se kishte ngritur flamurin rus.

"Bahmut është ukrainas dhe ata nuk kanë kapur asgjë dhe janë shumë larg që ta bëjnë këtë", i tha "Reuters"-it me telefon, Serhiy Cherevatiy, zëdhënës i komandës ushtarake lindore.

Zyrtarë ushtarakë të Ukrainës thënë në fund të marsit se forcat ruse kanë shënuar "një shkallë suksesi" në qytetin e vijës së frontit në lindje të Ukrainës, Bahmut. Ata shtuan se ushtarët ukrainas po vazhdojnë ende betejën disamujore në të cilën të dyja palët kanë pësuar një numër të madh viktimash.

Yevgeny Prigozhin, kreu i grupit mercenar rus, Wagner, tha më 29 mars se luftimet për qytetin ukrainas të Bakhmutit kanë shkaktuar dëme të rënda në forcat e tij, por edhe në palën ukrainase.

Qyteti i Bahmutit dhe qytetet përreth të rajonit industrial lindor të Donjeckut kanë qenë caku qendror i sulmeve gjatë 13 muajve qëkur ka nisur lufta në Ukrainë.

Rusia nisi pushtimin e paprovokuar të Ukrainës më 24 shkurt 2022.

Presidenti rus, Putin, e quan luftën "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën.

Perëndimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

# Blinken telefonon Lavrovin, i kërkon lirimin e gazetarit amerikan

UASHINGTON, 3 PRILL - Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, ka kërkuar lirimin e gazetarit të arrestuar të "Wall Street Journal" - në një telefonatë të rrallë me homologun e tij rus, Sergei Lavrov.

Lavrovi tha se ShBA-ja nuk duhet ta politizojë arrestimin.

Gazetari amerikan Evan Gershkovich u arrestua të premten me akuzën për spiunazh. "Wall Street Journal" i ka mohuar këto akuza.

Ministria e Jashtme ruse konfirmoi të dielën se Blinkeni dhe Lavrovi diskutuan për arrestimin e gazetarit amerikan në një telefonatë që u iniciua nga ShBA-ja.

Departamenti amerikan i Shtetit tha se Blinkeni përcolli "shqetësim të madh për ndalimin e papranueshëm të një gazetari amerikan nga Rusia".

Lavrovi u përgjigj duke përsëritur pretendimet e Rusisë se Gershkovich u kap "në flagrancë duke u përpjekur të merrte informacion të klasifikuar" dhe se çështja e tij do të trajtohet nga gjykatat ruse, thuhet në një deklaratë të MPJ-së ruse.





## Republikani Asa Hutchinson shpall kandidaturën për president



UASHINGTON, 3 PRILL - Ish-guvernatori i shtetit të Arkansasit, republikani Asa Hutchinson, ka bërë me dije se do të kandidojë për zgjedhjet presidenciale të vitit 2024. "Jam i sigurt se njerëzit duan udhëheqës që duan më të mirën e Amerikës", tha Hutchinson në një intervistë të transmetuar për programin "This Week" të televizionit ABC.

Ai tha se do ta bënte njoftimin zyrtar për shpalljen e kandidaturës në muajin prill në Arkansas. "Kam marrë një vendim dhe vendimi im është që do të kandidoj për president të Shteteve të Bashkuara", tha ai.

72-vjeçari Asa Hutchinson la detyrën në janar, pas tetë vjetësh si guvernator.

Ai ka shtuar kritikat e tij ndaj ish-presidentit muajt e fundit, duke e cilësuar rikandidimin e Trumpit si "skenarin më të keq" për republikanët dhe duke u shprehur se kandidimi i tij ka të ngjarë t'i shtojë shanset për fitoren e presidentit Joe Biden në vitin 2024.

Përveç Trumpit, kandidaturën për president nga radhët e republikanëve e ka shpallur edhe ish-ambasadorja e Shteteve të Bashkuara në OKB, Nikki Haley dhe sipërmarrësi Vivek Ramaswamy.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

## Donika Kadaj-Bujupi emërohet këshilltare e presidentes Osmani



PRISHTINË, 3 PRILL - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka emëruar të hënën Donika Kadaj-Bujupi këshilltare në kabinetin e presidentes. Presidenca ka njoftuar se Kadaj Bujupi ka përvojë të gjatë parlamentare si deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës në pesë mandate, ku ka shërbyer në komisione të ndryshme, përfshirë atë të politikës së jashtme, integrimit evropian, arsimit. "Përgjatë përvojës së saj profesionale, znj. Kadaj Bujupi ka punuar në organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, ndërsa është angazhuar vazhdimisht në tema të të drejtave të njeriut, barazisë gjinore, ambientit dhe arsimit. Në Presidencë, znj. Kadaj Bujupi do të angazhohet, ndër të tjera, në fushën e komunikimit publik dhe marrëdhënieve ndërkombëtare", thuhet në njoftimin e Presidencës.
Presidentja Osmani i ka uruar mirëseardhje Kadaj-Bujupit dhe ka theksuar se përvoja e saj e gjatë profesionale do të kontribuojë edhe më shumë në arritjen e objektivave të kabinetit të presidentes dhe avancimit të mëtutjeshëm të punës së Presidencë.

# Djegia e veturave në veri, Osmani: Veprime kriminale të mbështetura nga Beogradi



Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 PRILL - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të hënën në takim të dërguarin e posaçëm të Republikës Federale të Gjermanisë dhe Republikës së Austrisë për Ballkanin Perëndimor, Manuel Sarrazin dhe Johannes Eigner.
Osmani në takim ka folur edhe për djegien e veturave në veri, duke thënë se janë veprime kriminale të orkestruara nga struktura ilegale të mbështetura nga Beogradi, kanë për qëllim frikësimin dhe kanosjen e popullatës lokale serbe.
Në njoftimin e bërë për medie thuhet se "në takim është biseduar për zhvillimet e fundit në vend dhe rajon, përfshirë dakordimin e arritur për marrëveshjen bazë, si dhe planin e zbatimit në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë, si dhe zhvillimet e sigurisë në veri të Republikës së Kosovës".
Presidentja Osmani ka theksuar se Kosova vazhdon të angazhohet në mënyrë konstruktive për t'i kontribuar paqes afatgjatë në rajon.
Në këtë drejtim, presidentja ka theksuar se veprimet e fundit kriminale në veri të Republikës së Kosovës, të orkestruara nga struktura ilegale të mbështetura nga Beogradi, kanë për qëllim frikësimin dhe kanosjen e popullatës lokale serbe si dhe krijimin e një klime frike dhe pasigurie.
Pavarësisht prej kësaj, presidentja Osmani theksoi se Kosova do të vazhdojë të jetë plotësisht e koordinuar me aleatët ndërkombëtarë për t'i vazhduar përpjekjet për paqe, siguri dhe stabilitet të qëndrueshëm, ndërsa është e përkushtuar për zbatimin e rendit dhe ligjit në të gjithë territorin e Republikës.
Më tutje, në njoftimin e Presidencës thuhet se Osmani ka falënderuar Sarrazin dhe Einger për angazhimin e Gjermanisë dhe Austrisë për integrimin e plotë të Republikës së Kosovës në institucionet euroatlantike, teksa ka theksuar se koordinimi i Kosovës me aleatë do të vazhdojë.

# Rama do të nisë podcastin e tij: Flasim edhe me kundërshtarë, të ftuar politikanë e artistë



TIRANË, 3 PRILL - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, do të nisë së shpejti podcastin e tij, i cili do të quhet 'Flasim'. Rama thotë se në këtë podcast do të ketë të ftuar politikanë, por edhe njerëz nga sfera të ndryshme, si arti, media apo kultura.
Ai thotë se në këtë podcast nuk do të mungojnë as kundërshtarët e tij, të cilët do të marrin ftesë, por do të jenë në dorën e tyre nëse do të pranojnë një përballje me kreun e qeverisë. "Flasim është një eksperiencë re, për mua dhe ju. Flasim është podcasti im i menduar për të folur lirshëm në praninë tuaj me njerëz të njohur a të panjohur. Personazhe të skenës publike, politikës, artit, kulturës, medies, shqiptarë, të huaj, miqësorë apo jo ndaj meje. Por edhe protagonistë të jetës shqiptare aty ku nuk hyjnë sytë e vëmendjes publike, madje edhe kundërshtarë pse jo, nëse e pranojnë ndonjëherë ftesën. Kjo është dëshira! Flasim", ka shkruar Rama në "Facebook".

## Krasniqi: Shtetet e konsoliduara debatojnë për problemet reale, ne kemi mbetur të kurthuar në të kaluarën

PRISHTINË, 3 PRILL - Profesori universitar, Milazim Krasniqi, ka komentuar situatën e përgjithshme në Kosovë, duke thënë se kombet dhe shtetet e dobëta mbeten vazhdimisht peng të problemeve të kaluara dhe debateve për të kaluarën. Ai ka shkruar në "Facebook" se kombet dhe shtetet e konsoliduara debatojnë në kohë reale për problemet reale. "Ndërsa shtetet dhe kombet më të fuqishme e projektojnë të ardhmen. Ne kemi mbetur të kurthuar në të kaluarën. Shkaku i dobësisë sonë edhe të huajt po na trajtojnë në të kaluarën. Nëse vazhdon kështu, na shkatërrohet e tashmja dhe mund të mbetemi pa të ardhme", ka shkruar profesori Krasniqi.




Landi Susuri (RFE/RL Graphics)

ME FJALËN HYRËSE TË PROKURORISË KA NISUR GJYKIMI NDAJ THAÇIT, VESELIT, SELIMIT DHE KRASNIQIT

# Liderët e UÇK-së deklarohen të pafajshëm

Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi janë deklaruar të pafajshëm në nisjen e procesit gjyqësor kundër tyre në Gjykatën Speciale. Ata kanë thënë se asnjë nga pikat e aktakuzës nuk qëndrojnë. Ndërsa ZPS-ja në fjalën hyrëse ka paraqitur argumentet e saj në raport me aktakuzën kundër katër drejtuesve të UÇK-së. Procesi gjyqësor ndaj katërshes së UÇK-së do të vazhdojë edhe sot (e martë). Mbrojtja e Thaçit do ta paraqesë fjalën hyrëse

EPOKA E RE Lirim GECI

HAGË, 3 PRILL - Në Gjykatën Speciale në Hagë të hënën ka nisur seanca e parë gjyqësore ndaj krerëve të UÇK-së, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Në këtë seancë Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) ka paraqitur fjalën hyrëse. Në të kanë marrë pjesë fizikisht edhe Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi. Para se ZPS-ja ta vazhdonte paraqitjen e fjalës hyrëse, gjykatësi Çarls Smith III ka kërkuar nga të pandehurit të deklarohen sërish për aktakuzën e plotësuar për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.
Hashim Thaçi në deklarimin e tij ka thënë se është i pafajshëm. "Jam plotësisht i pafajshëm", ka thënë Thaçi.
Edhe Kadri Veseli është deklaruar "tërësisht i pafajshëm". "Po, gjithsesi, shpreh pakënaqësinë time për një vonesë të tillë dyvjeçare e gjysmë, megjithatë ju falënderoj. Jam tërësisht i pafajshëm", ka thënë Veseli.
Edhe Rexhep Selimi është deklaruar i pafajshëm. "Jam i pafajshëm për të gjitha pikat në aktakuzë", është shprehur Selimi.
Ndërsa Jakup Krasniqi ka thënë se e kupton akuzën, por është tërësisht i pafajshëm. "S'kam asnjë lidhje me pikat që i lexoi prokuroria para pak kohësh. Akuzën e kuptoj, por nuk pajtohem pasi nuk mbaj asnjë përgjegjësi për atë që flet akuza. Jam plotësisht i pafajshëm", ka thënë Krasniqi.
Pas deklarimit të drejtuesve të UÇK-së kanë folur prokurorët e Zyrës së Prokurorit të Specializuar.
Fillimisht prokurori Alex Whiting ka nisur deklarimin e tij. Ai ka thënë se katër të akuzuarit kanë qenë themelues të UÇK-së dhe të Shtabit të Përgjithshëm. Sipas tij, gjatë kohës që e mbulon aktakuza, ata kanë "mbështetur dhe zbatuar një politikë që vinte në shënjestër personat që shiheshin si bashkëpunëtorë, kolaboracionistë me Serbinë", por edhe persona që shiheshin se kundërshtonin UÇK-në apo përkrahnin Lidhjen Demokratike të Kosovës. "Shumica e viktimave ishin shqiptarë të Kosovës", ka thënë Whiting.
Ai ka pretenduar se motivi i kryerjes së këtyre krimeve të pretenduara në aktakuzë ishte "arsyeja ishte për të fituar pushtet në luftë në Kosovë ndaj personave që perceptoheshin si kundërshtarë të UÇK-së". "Mund t'i kenë kryer nga frika se kauza e tyre do të minohej nga ata që perceptoheshin si kundërshtarë. Mund të jenë kryer nga hakmarrja. Do të shihni prova për këto të dyja", ka thënë ai, duke shtuar se "qëllimi kriminal i përbashkët për të vënë në shënjestër kundërshtarët nuk ishte aspak i fshehtë".
Prokurori Whiting ka thënë se rasti ndaj katër krerëve të UÇK-së ka të bëjë me ta e jo me gjithë UÇK-në. "Kjo çështje gjyqësore nuk kërkon të procedojë UÇK-në dhe nuk i akuzon të gjithë anëtarët e saj. Akuzat ngrihen kundër katër vetave. Shumica e anëtarëve të UÇK-së nuk kishin të bënin fare me krimet për të cilat është ngritur aktakuza", ka thënë Alex Whiting.

## Prokuroria: Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi krijuan Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së

Në vazhdim të fjalës hyrëse, ZPS-ja ka thënë se përmes provave do të dëshmojë se UÇK-ja kishte hierarki dhe se të katër të akuzuarit kishin autoritet në Shtabin e Përgjithshëm.
Prokurori Alex Whiting ka thënë se Hashim Thaçi gjatë marrjes në pyetje në Hagë ka dëshmuar se Shtabi i Përgjithshëm ka qenë "jofunksional" dhe vetëm "në letër". Megjithatë, ai ka thënë se këto pretendime do të hidhen poshtë gjatë gjykimit. Në këtë kontekst, prokurori Matthew Halling ka dhënë një historik se si është krijuar UÇK-ja. Ai ka thënë se UÇK-ja ka buruar nga Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK) që "besonte se liria për shqiptarët mund të fitohej vetëm përmes forcës" dhe ishte në kundërshtim me politikën që ndiqte LDK-ja, që ishte rezistencë paqësore.
Po ashtu, ka përmendur disa prej deklaratave të bëra nga të pandehurit më herët në medie lidhur me Shtabin e Përgjithshëm dhe vetë UÇK-në, duke dhënë edhe intervista për gazeta të ndryshme. Mbrojtja e të pandehurve më herët ka thënë se UÇK-ja nuk kishte organizim.
Prokurori Matthew Halling ka vazhduar me deklaratën hyrëse, duke thënë se gjatë intervistimit në Hagë nga prokurorët e specializuar, Rexhep Selimi ka konfirmuar postet që katër të akuzuarit kanë pasur gjatë luftës në Kosovë. Më pas ai ka lëshuar një pjesë të intervistë në Hagë, ku Selimi flet se kush i shkruante komunikatat e UÇK-së dhe kush ishte përgjegjës për mesazhin që duhej nxjerrë në publik. Sipas Halling, Thaçi në fundin e vitit 1998 kishte marrë drejtimin e Drejtorisë Politike të UÇK-së, Veseli kishte qenë përgjegjës për Drejtorinë e Zbulimit, Selimi ishte inspektor i përgjithshëm i UÇK-së dhe Krasniqi ishte zëdhënës, pra "i ngarkuar për t'iu dhënë zë" politikave të këtij organizimi. Po ashtu, prokurori i specializuar përmendi një libër të shkruar

nga Krasniqi, që tha se flet për hierarkinë që kishte UÇK-ja dhe se ajo "duhej respektuar".
Prokurori i specializuar, Matthew Halling, ka thënë se Hashim Thaçi përmes një komunikate në mars të vitit 1999 njoftoi për themelimin e Qeverisë së Përkohshme, në të cilën ishte kryeministër. Sipas organogramit të paraqitur nga Prokuroria, Veseli ishte drejtues i Shërbimit Informativ të Kosovës (ShIK), Selimi ministër i Rendit dhe Krasniqi zëdhënës. Sipas Prokurorisë, qeveria vazhdonte ta njoftonte Shtabin e Përgjithshëm për veprimtaritë e kundërzbulimit dhe se ShIK-u kishte vazhduar punën kundër kolaboracionistëve.
Prokuroria, po ashtu, u ndal në marrëveshjen për çmilitarizim mes NATO-s dhe ish-Jugosllavisë, që mundësoi tërheqjen e trupave serbe nga Kosova.
Halling tha se misioni i NATO-s në Kosovë, KFOR, por edhe misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë, UNMIK, kishin hetuar krimet e pretenduara të luftës, por edhe shkeljet e marrëveshjes së çmilitarizimit.
Në vazhdim, prokurori i specializuar, Alan Tieger, ka thënë se përmes komunikatave të lëshuara, UÇK-ja synonte t'i paralajmëronte "kolaboracionistët" se do të vriteshin. Ai këtë deklaratë e ka mbështetur edhe te një intervistë që Krasniqi kishte dhënë për "Spiegel", ku kishte deklaruar se "kolaboracionistët janë paralajmëruar se do të vriten" nëse nuk ndryshojnë qëndrim.
Sipas tij, Shtabi i Përgjithshëm kishte dhënë urdhër të merreshin masa ndaj kujto që punonte kundër UÇK-së. Në këtë kuadër, ai ka përmendur disa qendra të pretenduara të ndalimit në Likoc e Drenoc. Sipas Tieger, emrat e disa personave që ishin ndaluar më 1998 në Drenoc dhe Likoc ishin shkruar "në bllok shënimet". Ai ka thënë se provat e prokurorisë do të dëshmojnë se vendimet e "ndërmarrjes së përbashkët kriminale" po zbatoheshin.
Më tutje, prokurori James Pace ka përmendur rastet e ndalimit të individëve nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK). "Anëtarët e UÇK-së ua hoqën lirinë qindra individëve pa proces të rregullt gjyqësor. Ka të paktën 440 incidente sa i takon ndalimit të personave", ka thënë prokurori Pace. Sipas tij, viktimat përfshinin persona që punonin në pylltari, bujqësi, gazetarë, mësues e të tjera. "Shumë ishin mbështetës të LDK-së ose thjesht nuk mbështetnin UÇK-në", ka thënë ai.
Sipas ZPS-së, ka pasur shumë keqtrajtime të të ndaluarve dhe, në rastet më të rënda, vrasje. "Të paktën 102 viktima nuk mbijetuan, por vdiqën mizorisht sepse konsideroheshin kundërshtarë", ka thënë prokurori Pace, duke shtuar se krerët e UÇK-së akuzohen se janë përgjegjës për këto vrasje. Sipas tij, të paktën 20 persona janë ende të zhdukur. Shumica e vendndalimeve ishin, sipas prokurorisë, selitë rajonale të zonave të UÇK-së.
Procesi gjyqësor do të vazhdojë edhe sot (e martë). Fjalën hyrëse do ta paraqesë mbrojtja e Hashim Thaçit.

### Provë e lodhtë e Speciales, u kapet krerëve të UÇK-së për arrestimin e qytetarëve që veshën uniformën e policisë serbe

Zyra e Prokurorit të Specializuar (SPS) në fjalën hyrëse në gjykimin e Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit ka paraqitur si provë një dokument të UÇK-së, në formë urdhri të dhënë. Në atë urdhër është thënë se duhet të arrestohen ata që kanë treguar lojalitet ndaj pushtuesit dhe janë uniformar me veshje të policisë serbe. "Urdhërohen komandantët e ZO të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që t'i urdhërojnë forcat e rendit (PU) të UÇK-së që t'i arrestojnë ata qytetarë që duke treguar lojalitet ndaj pushtuesit janë uniformuar me veshje të policisë serbe me çka kanë bërë tradhti ndaj popullit shqiptar", ka cituar ZPS-ja urdhrin e UÇK-së. Si argument, ZPS-ja ka përdorur se si Rexhep Selimi, Kadri Veseli e Hashim Thaçi kishin sulmuar 12 stacione të policisë serbe njëherazi. "Provat treguan se më 1997 UÇK-ja sulmoi 12 stacione të policisë me granatahedhës. Provat tregojnë se sulmi u organizua nga Rexhep Selimi teksa u ndihmua nga Thaçi dhe Veseli për t'i siguruar armët", ka thënë prokurori i ZPS-së.




# Diaspora proteston në Hagë, mbështet liderët e UÇK-së

Qindra qytetarë nga Kosova dhe diaspora kanë protestuar në sheshin "Laan van Reagan en Gorbatsjov" në Hagë në mbështetje të udhëheqësve të UÇK-së. Sheshi ndodhet rreth tri kilometra larg Gjykatës Speciale të Kosovës ku të hënën ka nisur gjykimi ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Në mesin e protestuesve ka pasur edhe mërgimtarë nga Gjermania, Kroacia dhe Zvicra. Protestuesit mbanin me vete pankarta të ndryshme, përmes të cilave kanë kërkuar liri për liderët e UÇK-së. "Mos ma gjyko lirinë", "Marshojmë për UÇK-në", "UÇK, NATO", "Kosova viktimë, Serbia agresore", kanë qenë disa nga pankartat që mbanin në duar protestuesit. Përpos mërgimtarëve, pjesë e kësaj pankarte kanë qenë edhe familjarët e Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit. Po në këtë protestë ka qenë edhe babai i Granit Xhakës, Ragipi, i cili e ka quajtur të padrejtë Gjykatën Speciale. Për të protestuar në Hagë kishin shkuar edhe gjenerali Kudusi Lame, deputetë dhe ish-deputetë të Kuvendit të Kosovës.
Djali i Kadri Veselit, Klestori, përmes një statusi në "Instagram", i ka falënderuar shqiptarët për përkrahjen masive që ua kanë dhënë krerëve të UÇK-së në marshin në Prishtinë dhe atë në Hagë. Klestori ka qenë i pranishëm të hënën në protestën e mbajtur në Hagë, ku kanë marrë pjesë mijëra mërgimtarë nga Austria, Gjermania, Zvicra e vende të tjera. "Faleminderit të gjithë shqiptarëve që masivisht u solidarizuan me prindërit tanë - si dje në Prishtinë, ashtu dhe sot në Hagë! Malli për babanë lehtësohet nga krenaria për të kur e shohim një përkrahje kaq të madhe. Krenar me UÇK-në. Faleminderit të gjithëve! Zoti qoftë me ju!", ka shkruar ai.




## Shqipëria mbledh nënshkrimet për rezolutë të re kundër asaj të Dick Martyt

**Prishtinë, 3 prill (ER)** - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka njoftuar se janë mbledhur nënshkrimet për një rezolutë të re mbi rezolutën e Dick Martyt. Ai ka thënë se rruga e drejtësisë për Kosovën, gjakun e derdhur për liri, dëshmorët e UÇK-së dhe heronjtë e saj të gjallë sot në Hagë, do të jetë e gjatë dhe e mundimshme. "I mblodhëm më në fund firmat në Asamblenë e Këshillit të Evropës për mocionin për një rezolutë të re mbi rezolutën e vitit 2011, ku pa asnjë fakt u ngritën akuzat e tmerrshme ndaj Ushtrisë së lavdishme Çlirimtare të Kosovës për trafikun e organeve njerëzore. Rruga e drejtësisë për Kosovën, gjakun e derdhur për liri, dëshmorët e UÇK-së dhe heronjtë e saj të gjallë sot në Hagë, do të jetë e gjatë, e mundimshme, madje edhe fyese deri në palcë, por drejtësia do të triumfojë në fund fare, sepse s'ka forcë në botë që ta damkosë si kriminale një luftë çlirimtare", ka shkruar Rama në "Facebook".



## Kurti mirëpriti iniciativën për hapjen e Odës Ekonomike Nordike në Kosovë

**Prishtinë, 3 prill** - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka zhvilluar të hënën takim me ambasadorin e Finlandës në Kosovë, Matti Nissinen. Qeveria ka njoftuar se Kurti e Nissinen biseduan për zhvillimet në vend dhe rajon dhe për bashkëpunimin e vazhdueshëm ndërmjet ambasadës finlandeze dhe institucioneve të Republikës së Kosovës si rezultat i marrëdhënieve të shkëlqyera dypalëshe. "Në shërbim të thellimit të tyre, sidomos të marrëdhënieve ekonomike dhe tregtare, kryeministri Kurti mirëpriti iniciativën për hapjen e Odës Ekonomike



# Historia 7 mijë vjet e vjetër e Kosovës përmes tri artefakteve të ekspozuara në ShBA




**Prishtinë, 3 prill** - Ministri e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka njoftuar se në Muzeun e Fieldit në Chicago tri artefakte të Kosovës po rrëfejnë historinë dhe kulturën tonë 7 mijë vjet të vjetër. Relievi i Kamenicës dhe dy figurinat terrakote të Bardhoshit janë pjesë e ekspozitës "Mbretërit e Parë të Evropës" së bashku me artefaktet e 11 vendeve të Evropës Juglindore. "Ky grumbullim i më shumë se 700 objekteve krah për krah nuk është shfaqur kurrë më parë si koleksion i përbashkët. Si i tillë po u ofron vizitorëve mundësi eksplorimi të historisë së ngritjeve në pushtet të mbretërve dhe mbretëreshave të para të Evropës së lashtë", ka njoftuar MKRS.

Ministria e Kulturës e ka mbështetur këtë paraqitje të trashëgimisë sonë kulturore si dhe tërë procesin e pjesëmarrjes së Muzeut Kombëtar të Kosovës në këtë ekspozitë e cila do të zgjas deri më 28 janar 2024.

## Vdes një punëtor i kompleksit metalurgjik "Trepça"

**Prishtinë, 3 prill** - Policia e Kosovës ka konfirmuar të hënën vdekjen e një punëtori të kompleksit metalurgjik "Trepça" në ambientet e ndërmarrjes. Lajmin e ka konfirmuar për "Radion Evropa e Lirë" zëdhënësi i Policisë së Kosovës për rajonin e Mitrovicës, Avni Zahiti.

Bazuar në hetimet fillestare, dyshohet se viktima ka rënë nga një lartësi në ambientet e punës.

"Policia ka pranuar informatën se në vendin e tij të punës, brenda kompleksit industrial 'Trepça', është gjetur pa shenja jete viktima mashkull, 58-vjeçar. Hetuesit policorë, me autorizim të prokurorit, kanë nisur hetimet për identifikimin dhe zbardhjen e rrethanave të rastit".

Me urdhër të prokurorit trupi i pajetë dërgohet në Institutin e Mjekësisë Ligjore për obduksion, ka thënë Zahiti.

Kompleksi metalurgjik "Trepça" gjendet në komunën e Mitrovicës dhe ka rreth 1 300 punëtorë. Sektorët e tij gjenden në pjesën veriore dhe atë jugore të qytetit.

Trepça është shoqëri aksionare. 80 për qind e aksioneve janë të Qeverisë së Kosovës, kurse 20 për qind janë aksione të punonjësve të kësaj ndërmarrjeje.



# Të enjten Kuvendi mban seancë plenare

Prishtinë, 3 prill - Nën drejtimin e kryetarit Glauk Konjufca, kryesia e Kuvendit të Kosovës ka mbajtur të hënën mbledhjen e radhës.

Kryesia vendosi që të enjten, më 6 prill 2023, në orën 10:00, Kuvendi të mblidhet në seancë të rregullt plenare.

Në këtë seancë, pas deklarimeve jashtë rendit të ditës dhe pyetjeve parlamentare, Kuvendi pritet ta shqyrtojë Propozim-Rezolutën për punën dyvjeçare të Qeverisë së Kosovës dhe më pas tri projektligje në lexim të dytë: Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për energjinë, Projektligjin për sanksionet e shënjestruara kundër shkelësve të huaj të të drejtave të njeriut, si dhe Projektligjin për Agjencinë e Kosovës për Akreditim.

Për herë të parë do të shqyrtohet Projektligji për Pensionet e Zyrtarëve Policorë të Policisë së Kosovës dhe Punonjësit e Inspektoratit Policor të Kosovës me autorizime policore si dhe ai për çmimin e produkteve mjekësore.

Pikë e fundit e rendit të ditës e kësaj seance do të jetë shqyrtimi i rekomandimit lidhur me auditimin e procesit të shitjeve me negocim direkt në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Kryesia në këtë mbledhje, konform përgjegjësive të saj kushtetuese, shqyrtoi edhe çështje të tjera nga fushëveprimtaria e Kuvendit.



## Spitali i Gjakovës mbushet me mbeturina, punëtorët e pastrimit në grevë

**Gjakovë, 3 prill** - Në Spitalin e Përgjithshëm të Gjakovës "Iza Grezda" tash e një javë korridoret janë mbushur me thasë me mbeturina. Një qytetar ka raportuar se thasët e mbushura me mbeturina mjekësore të spitalit janë duke qëndruar në korridore për shkak se punëtorët që përkujdesen për pastërtinë e këtij objekti janë në protestë për rritjen e pagave.



"LIRIA KA EMËR" FALËNDERON TË GJITHË ATA QË KONTRIBUUAN NË "MARSHIN PËR DREJTËSI"

# Hoxha e Tasholli: Ky ishte marshi i dinjitetit qytetar

Ideatorët e platformës "Liria ka emër", Eliza Hoxha dhe Ismail Tasholli, kanë mbajtur të hënën një konferencë për medie në të cilën i kanë falënderuar të gjithë ata që kontribuuan për realizimin dhe mbarëvajtjen e "Marshit për drejtësi" për ish-krerët e UÇK-së në Hagë. Ata theksuan se "Marshi për drejtësi" ishte "marshi i dinjitetit qytetar"




EPOKA E RE Mal QORRAJ

PRISHTINË, 3 PRILL - Ideatorët e platformës "Liria ka emër", Eliza Hoxha dhe Ismail Tasholli, i kanë falënderuar të hënën të gjithë ata që kontribuuan në realizimin dhe mbarëvajtjen e "Marshit për drejtësi" për ish-krerët e UÇK-së në Hagë.
Eliza Hoxha ka thënë se të dielën ishte një ditë madhështore, në të cilën tërë Kosova u bashkua për historinë e saj. "Dje ishte një ditë madhështore. Të gjitha rrugët dje çuan në Prishtinë. Dje Kosova u bashkua për historinë e saj. Dje Prishtina ishte e vogël për t'i përqafuar zemrat e mëdha të qytetarëve tanë. Përulësisht faleminderit për të gjithë ju! Një falënderim i veçantë për ju medie, për peshën dhe hapësirën që i dhatë marshit dhe mesazhit unifikues që përçuat", ka theksuar ajo.
Hoxha ka shtuar se maturia e qytetaria e treguar dje ishin për t'u admiruar. "Na kishte marrë malli me i pa krejt bashkë, me e pa rizigjimin e Kosovës me krejt ngjyrat e saj. Por krejt kjo do të ishte e pamundur pa vullnetarët që ndihmuan në organizim dhe mbarëvajtje, bashkë me Policinë e nderuar të Kosovës. Maturia e qytetaria e djeshme ishin për t'u admiruar. Faleminderit!", ka thënë Hoxha.
Në anën tjetër, Ismail Tasholli i ka falënderuar bizneset, komunat, bashkësitë fetare dhe të gjitha grupet e tjera shoqërore. "Zemrën e madhe të bizneseve që gjithmonë kur është në pyetje UÇK-ja nuk kursejnë asgjë. Afishet, bluzat, posterët, mesazhet, flamujt e çka jo tjetër, u bënë të mundura nga ata. Faleminderit! Komunat e Kosovës, bashkë me kompanitë e transportit që i mundësuan gjithsecilit të vijë në Prishtinë dje. Faleminderit! Ky marsh e ky mesazh nuk do të shkonte te të gjitha audiencat pa personalitetet me influencë kulturore brenda dhe jashtë Kosovës. Falënderojmë edhe bashkësitë fetare, sportistë, klubet e sportit, tifozët, shoqatat e dala nga lufta që nuk kursyen asgjë", ka thënë Tasholli.
Tasholli ka theksuar se "Marshi për drejtësi" ishte marsh i dinjitetit qytetar. "Familjarëve të çlirimtarëve tanë, faleminderit që ishit dje me ne! Ky nuk ishte vetëm një marsh i rëndomtë, ky ishte marshi i dinjitetit qytetar, që di t'i peshojë vlerat themeltare të saj. E Kosova më shumë se kurrë ka nevojë të jetë bashkë sot. Faleminderit!", është shprehur Tasholli.
"Marshit për drejtësi" të dielën i janë bashkuar rreth 100 mijë qytetarë, përfaqësues të partive politike dhe familjarë të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.
Përpos flamurit të Kosovës dhe të UÇK-së, qytetarët mbanin edhe parullat: "Liria ka emër", "UÇK-ja, krenaria jonë", "Drejtësi për çlirimtarët" etj.

# BE-ja shpreson se ngjarjet në veri nuk do të ndikojnë në takimin Bislimi - Petkoviq



BRUKSEL, 3 PRILL - Bashkimi Evropian ka kërkuar nga Kosova dhe Serbia të përmbahen nga vlerësimet të cilat mund ta prishin atmosferën në dialog dhe thotë se shpreson që ajo që ka ndodhur ditët e fundit në veri të Kosovës nuk do të ndikojë në takimin e kryenegociatorit të Prishtinës dhe të Beogradit të cilët do të takohen të martën në Bruksel. Kështu tha të hënën në një konferencë për medie zëdhënësi i BE-së, Peter Stano.
Zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi dhe shefi i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petkoviq, do të takohen më 4 prill në Bruksel për të "diskutuar për hapat e ardhshëm për zbatimin e marrëveshjes për rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë", kanë thënë zyrtarët evropianë.
Stano ka bërë me dije se presin nga të dyja palët "të kontribuojnë në krijimin dhe mbajtjen e një atmosfere e cila ndihmon normalizimin dhe pajtimin dhe nevojën për implementimin e obligimeve që palët kanë marrë mbi vete". Gjithashtu, ai ka shtuar se "palët janë pajtuar të përmbahen nga çfarëdo veprimi i cili do të kishte efekt negativ".
Më 27 shkurt kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, kanë pranuar marrëveshjen për normalizimin e marrëdhënieve në bazë të propozimit evropian, ndërsa më 18 mars në Ohër janë pajtuar për Aneksin për zbatimin e saj.
Stano e quajti takimin e nesërm si "shumë të rëndësishëm" ngaqë, siç tha, "palët do të mblidhen për herë të parë që nga marrëveshja e Ohrit dhe do të diskutojnë pikërisht për hapat e nevojshëm për implementimin e obligimeve që dalin nga ajo marrëveshje dhe nga aneksi i saj". Ai tha se marrëveshjet e arritura kishin për qëllim pikërisht largimin nga faza e krizave.
Mbrëmjen e së shtunës janë djegur tri vetura në Leposaviq, komunë e banuar me shumicë serbe në veri të Kosovës. Dy prej veturave ishin me targa RKS, ndërsa njëra me targa të Beogradit. Më pas, Policia e Kosovës njoftoi se e kishte arrestuar një pjesëtar të komunitetit serb në Mitrovicën e Veriut nën dyshimin se, ndër të tjera, ka marrë pjesë në djegien e një veture.

# Punëtorët në grevë, bordi i KEK-ut i hapur për dialog

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 PRILL - Punëtorët e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) kanë mbajtur të hënën grevë njëorëshe. Në njoftimin e Sindikatës së Re Korporata Energjetike e Kosovës është bërë me dije se greva mbahet lidhur me kërkesën për ngritjen e pagave. Bordi i Drejtorëve i Korporatës Energjetike të Kosovës ka njoftuar se ka shqyrtuar kërkesat dhe shqetësimet e punonjësve lidhur me pagat në ndërmarrje dhe gjithnjë do të jetë i hapur për dialog me punëtorët dhe sindikatat. "Bordi i Drejtorëve i Korporatës Energjetike të Kosovës shpreh falënderimin e tij për të gjithë punonjësit e KEK-ut, në veçanti të atyre që punojnë në Divizionin e Prodhimit të Qymyrit (DPQ) dhe Termocentralet Kosova A (TCA) dhe Kosova B (TCB) për angazhimin e tyre të palodhshëm. Bordi i KEK-ut njofton të gjithë punonjësit dhe opinionin se punëtorët e saj vlerësohen si aseti më i rëndësishëm i funksionimit të korporatës dhe KEK ka prioritet bazë zhvillimin, rritjen dhe modernizimin e tij si dhe përmirësimin e mirëqenies së punëtorëve. KEK-u në vazhdimësi ka shqyrtuar kërkesat dhe shqetësimet e punonjësve lidhur me pagat në ndërmarrje dhe gjithnjë do të jetë i hapur për dialog me punëtorët dhe sindikatat", është thënë në njoftimin e KEK-ut, duke theksuar se paga mesatare në KEK është mbi pagën mesatare në sektorin publik dhe privat në Kosovë. "Po ashtu të gjithë punonjësit e KEK-ut, përfitojnë nga sigurimi shëndetësor, transporti, pagesa shtesë për përvojën e punës si dhe pagesa për shujta. Duam të potencojmë se gjatë



vitit 2022 punonjësit e KEK-ut kanë treguar një performancë të mirë, prandaj për këtë qëllim bordi së fundmi, përmes një vendimi në muajin dhjetor 2022 ka shpërblyer të gjithë punonjësit me nga 500 euro bonus për punën dhe kontributin e dhënë gjatë vitit 2022", theksohet në njoftim.

Më tej është theksuar se bordi i KEK-ut është duke punuar për rishikimin funksional të ndërmarrjes dhe për këtë qëllim do të ketë një ristrukturim dhe transformim i cili planifikohet të fillojë në fund të vitit 2023 dhe pas kësaj struktura dhe nivelizimi i pagave do të shqyrtohen pas këtij ristrukturimi dhe transformimi, në përputhje me strategjinë dhe mundësitë e reja zhvillimore të ndërmarrjes.

# Punësimi më i lartë te burrat/djemtë 46.6 për qind, te gratë/vajzat 17.9 për qind

PRISHTINË, 3 PRILL - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP) për tremujorin e parë 2022. Sipas rezultateve, dy të tretat e popullsisë në Kosovë janë popullsi në moshë pune. Në popullsinë e moshës së punës përfshihen moshat 15-64-vjeçare.

Në kuadër të popullsisë në moshë të punës, shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore është 38.6 për qind.

Shkalla e punësimit në Anketën e Fuqisë Punëtore (AFP) për tremujorin e parë (TM1) 2022 është 32.2 për qind.

Punësimi më i lartë është te burrat/djemtë 46.6 për qind, ndërsa punësimi te gratë/vajzat është 17.9 për qind.

Gratë/vajzat janë të punësuara kryesisht në sektorin e arsimit,



tregtisë dhe kujdesit shëndetësor, me 46.4 për qind të tyre, ndërsa burrat/djemtë janë kryesisht të punësuar në sektorin e tregtisë, ndërtimtarisë dhe prodhimit me 36 për qind.

Sektorët ekonomikë, që prijnë me punësim, vazhdojnë të jenë: tregtia me 15.5 për qind duke vazhduar me arsimin me 9.5 për qind, aktivitete të shërbimeve të tjera 9.1 për qind, prodhimi me 8.7 për qind dhe ndërtimtaria me 7.8 për qind. Ndërsa sektorët e tjerë marrin pjesë me përqindje më të vogël në punësim.

Sa iu përket të punësuarve me kontrata, del se 47.1 për qind e personave të punësuar kanë kontratë të përhershme në punën e tyre kryesore, ndërkohë që 52.9 për qind kanë kontratë të përkohshme. Sipas rezultateve të AFP-së, në TM1 2022 shkalla e papunësisë është 16.6 për qind.

Papunësia më e theksuar është te gratë/vajzat me 18.9 për qind krahasuar me burrat/djemtë, 15.6 për qind. Shkalla më e theksuar e papunësisë është te grupmoshat 15-24 vjeçare me 31.4 për qind.

Sipas rezultateve të AFP-së, në TM1 2022, fuqia joaktive është mjaft e lartë me 61.4 për qind, me fokus të veçantë te gratë/vajzat me 77.9 për qind, krahasuar me burrat/djemtë 44.8 për qind.

Për realizimin e AFP-së, TM1 2022, metodologjia dhe standardet e aplikuara nga ana e ASK-së janë të harmonizuara me rekomandimet e Eurostat-it.

## Ministri Peci viziton fermerin Arben Avdiu: Jemi në shërbim të fermerit

PRISHTINË, 3 PRILL - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, ka qëndruar për vizitë te fermeri Arben Avdiu nga fshati Abri e Poshtme e Drenicës. Tani e shumë vjet familja Avdiu kultivon fidanë të perimeve, si speca, tranguj, domate, dredhëza etj, ndërsa këtë vit synon t'i kultivojë rreth 100 mijë fidanë.

Gjithashtu, veprimtari tjetër e kësaj familjeje janë edhe lulet dhe drunjtë dekorativë. Duke parë angazhimin e Arbenit dhe dashurinë e tij për ta punuar tokën, ministri Peci tha se Arben Avdiu është një fermer shembull i cili kujdeset edhe për fermerët e tjerë me ofrimin e shërbimeve këshillimore, ngaqë ai ka 20 vjet që merret me këtë veprimtari. "MBPZhR është e do të jetë gjithmonë në shërbim të fermerëve të Kosovës. Rezultatet tashmë po vërehen në çdo cep të Republikës sonë", ka thënë ministri Peci, i cili ka shtuar se në Drenicë, sipas fermerëve, ka toka bujqësore të punuara. "Më shumë se asnjëherë më parë ne e presim përfundimin e procesit të aplikimit për të vërtetuar një gjë të tillë. Ndjeshëm po rritet edhe prodhimtaria e ushqimeve bio, që është edhe një objektiv madhor e ne po e shoqërojmë edhe me politika e masa shtesë të përkrahjes financiare", ka thënë ai.

Ministri i BPZhR-së ka potencuar se bashkë me Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës do ta përcjellin me kujdes punën e fermerëve në kuadër të angazhimit që sasia e pesticideve të jetë në nivelet e lejuara sipas parametrave të bujqësisë.



AJAZ EMINI - Ditar (VIII)

# NJË JETË KUSHTUAR ATDHEUT



### PËRFUNDIMI I KAMPANJËS 78 DITORE TË BOMBARDIMEVE TË NATO's NË OPERACIONIN E FORCAVE ALEATE "OPERATION ALLIED FORCE"

Në kampanjën 78 ditore të bombardimeve mbi forcat serbe dhe shtetin e ashtuquajtur Jugosllavi, ku kishin mbetur vetëmse Serbia dhe Mali i Zi, kontribuan 19 shtetet, shtete të Aleancës së Atlantikut, dhe ata ishin: Belgjia, Kanada, Republika Çeke, Danimarka, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Islanda, Itala, Luksemburgu, Holanda, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Spanaja, Turqia, Mbretëria Britaneze (Anglia) dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.
Koha e sulmit: Ora 14:00 sipas kohës EST, 24 Mars 1999
Pezullimi i bombardimeve: Ora 10:00 sipas kohës EST, 10 Qershor 1999
Kampanja bombarduese u ndërpre në: Ora 10:50 sipas kohës EST, 20 Qershor 1999
Forcat e armikut:
Forcat Tokësore: 114,000 ushtarët e rregult edhe 1,400 armë artilerike.
Forcat Kundër-Ajrore: 100 raketa tokë-ajër: përzierje e SA-2, SA-3, SA-6, SA-7, SA-9, SA-13, SA-14 dhe SA-16. Që të gjitha këto armë ishin rrezik i madhë për fuqinë ajrore të NATO-së. Jugosllavia gjithashtu kishte edhe 1,850 armë artilerike mbrojtëse kundër- ajrore
Forca Ajrore: 240 aeroplanë luftarak, duke marrë MIG-21 edhe MIG-29, si dhe 48 helikopterë luftarak.
Forcat Mekanizuese: 1,270 tankeve T-72, T-74, T- 55 dhe M-84 si edhe 825 automjeteve të blinduara luftarake.
Mbrenda dhe rreth Kosovës kishin rreth 40,000 trupat e armatosura me tanke dhe APC's.

Pjesëmarrja e SH.B.A.: Gjithsej me; 31,600 persona



-Personel Tokësorë -18,400 trupa
-Personel Detarë -13,200

Forcat Detare:

-Cruisers: USS Vella Gulf (CG 55)
-Destroyers: USS Gonzales (DDG-66), USS Ross (DDG-71) edhe USS Peterson (DD969)
-Aeroplanë mbajtësit: USS Theodore Roosvelt (CVN 71)
-Nëndetëse: Albuquerque (USS 706) edhe USS Boise (SSN 764)
The Kearsarge Amphibious Ready Group: USS Kearsarge (LHD4), USS Ponce (LPD 15) dhe USS Gunston Hall (LSD 44)
Kontribuesit e Aleancës Detare në Operacionin e Forcave Aleate
- 2 Aeroplanë mbartëse (UK/FR)
- 1 Nëndetëse (UK)
- 6 Destroyeers (UK/FR/GR/IT)
- 10 Frigates (UK/SP/TU/IT/NL/GE/GR)

Asetet e kampanjës ajrore:
- F-15 Strike / Eagle (Aeroplan sulmi Ajër- Tokë)
- F-16 Fighting / Falcon (Aeroplan luftarak shumë dimensional)
- F-117 Nighthawk (Aeroplaneluftarak / sulmues)
- B-52 Stratofortress (Aeroplan bombardues i rëndë)
- B-1B Lancer (Aeroplan tej-oqeanik, me rol shumë dimensional, bombardues i rëndë)
- B-2 Spirit (Aeroplan shumë-dimensional, bombardues i rëndë)
- A-10 Thunderbolt II (Aeroplan ndihmës i afërt)
- KC-135 (Aeroplan tanker për rimbushje karburantësh)
- KC -10A Extender (Aeroplan tanker për rimbushje karburantësh)
- F-14 Tomcat (Aeroplan luftarak)
- AV-8B Harrier (Ndihmës i afërt ajrorë)
- EA-6B Prowler (Aeroplan për luftë elektronike)
- AC-130 Spectre (Aeroplan ndihmës ajrorë, ndërlidhës dhe zbulimi)
- AC-130 Hercules (Aeroplan bartës mbrenda arenës)
- C-141 Starlifter (Kargo dhe transportues i trupave)
- C-17 Globemaster III (Kargo dhe transportues i trupave)
- FA-18 Hornet (Aeroplan luftarak)
- E-8C Joint Stars (Aeroplan zbulimi nga toka)
- RQ-1A Predator (Aeroplan shumë dimensional, zbulimi etj.)
- Hunter (Aeroplan pa pilot)
- AH-64A Apachee (Helikopter sulmues)
- C-5A (Aeroplan shpëtimi)
Ndihma Ajrore e Aleancës në Operacionin e Forcave Aleate:
- 277 aeroplanë
- 192 aeroplanë luftarak/bombardues
- 63 aeroplanë ndihmës
- 19 aeroplanë zbulues (reconnaissance)
- 3 helikopterë

Sipas informatave të NATO-së SHBA ishte lideri kryesorë me numrin pjesëmarrës të flotës së aviacionit si dhe me numrin e sulmeve mbi objektivat e armikut serb.
Nga fillimi i Operacionit të Forcave Aleate të NATO-së në 24 Mars 1999, atëherë kur kishin planifikuar të sulmohen veçëse 51 caqe, (për shkak se parashikohej që operacioni do të zgjasë vetëmse 2-3 ditë, derisa të dorëzohej Milloshevigi) e deri më 10 qershor 1999, në nënshkrimin e kapitulimit serb të "Marrëveshjes Tekniko Ushtarake të Kumanovës", u realizuan mbi 3800 fluturime, dhe i tërë operacioni ishte planifikuar për 5 faza, e kurse Serbia bëri dorëzimin vonë në fazen e 4'të.
Gjatë kësajë kohe u bombarduan mëse 976 caqe, për shkak se NATO nuk e kishte paraparë se do të jetë kampanjë kaq e gjatë ashtu siç ndodhi. Secili nga 807caqet e më vonshme bëhej me propozimin, rishikimin dhe aprovimin prej pjesëmarrësve të NATO-së, e që na tregon se ishte operacion mjaftë i ndërlikuar, sepse në mes vete palët kishin mjaftë kundërshtime që shkaktonin pengesa edhe në efikasitetin ushtarak të operacioneve. -Numri më i madhë i propozimeve për bombardimet e caqeve potenciale ishin edhe prej SHBA-së, për shkak se ata ishin edhe forca kryesore që ishin në këtë arenë të sulmeve, përshkakse e kishin edhe forcën më të madhe të aseteve të intelegjencës në skenën e luftës! Kurse në anën tjetër pjesëtarët tjerë aleate të NATO-së kishin caqe aq sa kishin mundë t'i gjejnë vetë ata!
Gjatë këtijë operacioni u shfrytëzuan 1031 aeroplanë si dhe mbi 30 anije luftarake dhe nëndetëse. Bombardimet e NATO-së në përgjithësi bëheshin nga një lartësi rreth 5,000 metrash apo 15,000 feet, që e bënte të pamundur që të qëlloheshin nga armë të kundërajrore të armikut, të forcave jugosllave.
Objektivat e propozuara i jipeshin Këshillit të Përbashkët Koordinues të caqeve të cilët udhëhiqeshin nga Lt. Gjenerali Michael Short, i cili ishte komandues për Aleancën e Forcave të Evropës Jugore (AFSOUTH) edhe Nën Admirali Daniel Murphy dhe komandues i Forcave Sulmuese dhe Forcave Ndihmëse të AFEJ (AFSOUTH).
Këshilli pastaj ia kalonte objektivat e propozuara komandës ndërlidhëse, së pari Komandës AFSOUTH Admiralit James Ellis dhe pastaj tek SACEUR Wesley Clark.Gjenerali Clark secilin objektiv veçë e veçë e rishikonte vetë për të vendosë se a hyjnë mbrenda rregullave të dhanuna nga Këshilli i Atlantikut Verior. Menjëherë pas aprovimit të caqeve të propozuara nga Clark'u pastaj fillonte procesi i rishikimit politik të caqeve.
Gjatë javës së parë të kampanjës ajrore të NATO- së, secili objektiv kishte për t'u rishikuar veçë e veçë nga secili shtet pjesëmarrës. Verifikimi bëhej nga oficerët ushtarak dhe udhëheqësit politik të secilit prej19 shteteve të NATO-së pjesëmarrëse, duke i bërë analizat specifike të tyre dhe duke parashikuar edhe numrin e viktimave civile që do të shkaktoheshin nga bombardimi.
Sipas Pentagonit llogariten se mëshumëse 80% të caqeve të goditura në katër javët e para ishin sulmuar edhe më tepër se një herë.
Pas disa javësh të bombardimeve, Këshilli i NATO-së vendosi që ta largojë veten nga rishikimet për shkak të kohës që po mirrte, edhe t'ia besojë në përgjithësi Gjeneralit Wesley Clark.
Sipas Clark'ut secili shtet kishte avokatët e tyre që të rishikojnë prej së afërmi caqet para se pilotët e tyre të fluturojnë për t'i qëlluar. Secili pjesëtarë i aleancës së NATO-së kishte të drejtën e tyre për veto në këto caqe, si shembull konkret Holanda në vazhdimsi kundërshtonte bombardimin e Pallatit Presidencial (të Milloshevigit) në Beograd, për shkak të vizatimeve të artistit të mirënjohur Rembrand, që ishin të vendosura në muret e katit të parë të ndërtesës së presidentit serb.
Sekretaresha e Shtetit, Medelaine Albright për çdo ditë kishte tele-konferencë me ministritë e →

punëve të jashtme të 5 shteteve: Britanisë, Francës, Gjermanisë dhe Italisë dhe e cila me shumë sukses e mbajti bashkimin e unionit të shteteve.
Prej19 shteteve të aleancës së NATO-së, Franca ishte ajo e cila ushtronte të drejtën e vetos më së shumti, si dhe në vazhdimsi refuzonte që të autorizojë bombardimin e caqeve përmbrenda Mali të Zi, për të cilët thonin se nuk duhet sulmuar ato sepse ato janë më pakë armiqësorë se sa Serbia.
Franca gjithashtu refuzoi që të bombardohen urat e Beogradit, rafineritë e naftës, antena televizive, si dhe largëpërçuesit elektrik mbrenda Serbisë.
Në 78 ditët e bombardimeve të NATO-së, që filloi nga masakra e Reçakut më 24 Mars 1999 e deri më 10 qershor 1999, pas nënshkrimit të Marrëveshjes Tekniko Ushtarake të Kumanovës.
Sipas informatave serbe thuhet se nga pala e tyre kishte rreth 2,500 të vrarë, 12,500 të plagosur, 470 Km. rrugë të shkatërruara si dhe 600 Km. hekurudhë të shkatërruar.
Sipas informacioneve të NATO's, gjatë këtijë operacioni thuhet se sulmuesit e NATO's armikut jugosllav i vranë mëse 5,000 ushtarë, rreth 10,000 ushtarë të lënduar, i shkatërruan 121 aeroplanë dhe helikopterë, 120 tanke, 220 autoblinda, 339 automjete ushtarake dhe 450 sisteme artilerike të shkatërruara.
Nga pala e NATO-së ishin vrarë 2 ushtarë amerikan në aksident të helikopterit Apache AH-64, 2 aeroplanë të rrëzuar, 3 aeroplanë të dëmtuar dhe 2 helikopterë Appachee AH-64 të cilët patën aksident dhe ranë në malet e Shqipërisë gjatë manovrimeve të natës.
Nga aviacioni i NATO-së thuhet se u vranë 489- 528 civilë kosovarë.
Nga pala shqiptare kishte të vrarë dhe të humbur 8,676 njerëz, dhe mbi 90% e popullatës civile ishte dëbuar nga shtëpitë e tyre. Numri total i tërë popullatës civile të vrarë në Kosovë kishte mbërrirë në 13,548 njerëz (shqipëtarë, serb, boshnjak, rom etj.)

## KY ISHTE FORMACIONI PËRBËRËS I "OPERACIONIT TË FORCAVE ALEATE"

### SHBA:

Ishte shteti i aleancës së NATO-së që solli më tepër se 700 aeroplanë luftarak, prej 1055 sa kishte gjithësej në flotën e sajë të aviacionit.
Në arenën e Operacionit të Forcave Aleate që u ndërmor kundër Serbisë, Amerika zenë vendin e parë të sulmeve me mbi 60%, dhe me aviacionin e tyre luftarak me 90%, ose me mëse 29.000 fluturimeve, si në sulm, në mbrojtje dhe furnizimin me karburantët e bombarduesve derisa po fluturonin për apo nga caqet e tyre.
-Gjithëashtu Amerika ishte njëri prej aleatëve kryesore që shkrepi më së shumti raketat:ajër-ajër, ajër-tokë, si dhe nga nëndetëset dhe anijet e marinës luftarake që po sulmonin nga Deti Adriatik, në objektivat e caktuar mbrenda tërë teritorit të Jugosllavisë.
Gjatë këtijë operacioni Amerika kishte në dispozicion 214 aeroplanë sulmues, 18 bombardues, 25 aeroplanë ISR, 38 aeroplanë të operimeve special dhe 43 aeroplanë kundërsulmi.

### Franca:

Gjatë këtijë operacioni Franca kishte rreth 100 aeroplanë në arenën e luftës, dhe gjatë kësajë kohe kishin kryer 2414 fluturime. Prej aviacionit luftarak në Operacionin e Forcave Aleate, Franaca kishte; 8 Mirage 2000 D's, 12 Jaguar aeroplanë sulmues, 6 Mirage F-1 CT's, 3 Mirage IV P's si dhe disa Super Entendars.

### Gjermania:

Në Operacionin e Forcave Aleate, Gjermania për herë të parë që nga lufta e Dytë Botërore po mirrte pjesë direkte në një luftë jashta shtetit të tyre.Shkaku se me marrëveshjen ndërkombëtare të paqes, ajo ishte e dënuar nga forcat aleate për shkak të agresionit të Hitlerit, i cili ishte edhe shkaktarë i fillimit të Luftës së Dytë Botërore, të cilën luftë Gjermania e humbi nga forcat aleate!
Me pjesëmarrjen e tyre në këtë operacion, aviacioni Gjerman kishte kryer 636 fluturime, dhe në këtë arenë operaconi kishin;14 aeroplanë Tornados si dhe drone CL-289 për vëzhgim dhe mbledhjen e informatave nga arena e operacionit.

### Italia:

Ishte vendi i tretë si kontribues me numrin e aeroplanëve luftarak në Operacionin e Forcave Aleate, dhe ishte vendi i katërtë me fluturime.
Forcat Italiane kishin në shfrytëzim; 18 Aeroplanë IDS-së si dhe disa aeroplanë AMX.
Italia ishte shteti që i ofroi aeroportet e tyre për fluturim sulmesh të gjithë aleancës së aviacionit të NATO-së për shkak të pozitës së afërt që kishte me Kosovën dhe Jugosllavinë.

### Holanda:

Forcat Ajrore të Mbretërisë së Holandës gjatë këtijë operacioni ofruan: 2 KDC-10 tankera karburanti dhe 18 aeroplanë luftarak F-16A, të cilët kishin kryer 1252 fluturime.

### Mbretëria e Bashkuar (Anglia):

Forcat Mbretërore RAF në radhë ishin kontribuesit e dytë pas forcave të SHBA-së në këtë arenë luftarake të Operacionit të Forcave Aleate, aty ku kishin sjellur: 45 aeroplanë luftarak dhe të cilët kishin bërë 1950 fluturime.
Anglia kishte sjellë:4 aeroplanë Sulmues dhe 16 aeroplanë Harrier CR7, 7 aeroplanë Harrier FA2, 3 aeroplanë Tornado GR1, 3 aeroplanë E-3D, 1 aeroplanë Nimord, 4 aeroplanëTristars, 5 aeroplanë VC10 për karburante, 9 tankera karburanti dhe të cilët mbulonin mbi 80% të rimbushjes së aeroplanëve luftarak.




## FORCAT E KOSOVËS (KFOR / THE KOSOVO FORCE) TASK FORCA SKIFTERI (TASK FORCE FALCON)

KFOR'i është forcë paqëFuajtëse ndërkombëtare në Kosovë, operacionet e së cilës kanë për qëllim mbrojtjen dhe demilitarizimin e vendit, si dhe të sigurojnë lëvizjen e lirë dhe të sigurtë për të gjithë popullatën, si dhe të ndihmojë në proceset integruese Euro-Atlantike, si dhe numri i tyre të zvoglohen gradualisht për derisa të bëjnë tranzicionin mbrojtës në Forcat e Sigurisë së Kosovës apo Forcat e Arma- tosura të Kosovës.
Trupat paqëruajtëse të KFOR'it hyrën në Kosovë më 11 Qershor 1999, dy ditë pas adaptimit të Rezolutës së Kombeve të Bashkuara 1244, atëherë kur Kosova po përballej me krizën humanitare të shkaktuar nga forcat paramilitaro ushtarako policore jugosllave, me preteks kinse po ndërmerrnin akcionin e tyre kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Por, qëllimi kryesorë i tyre ishte pastrimi etnik shqiptarë, duke bërë dëbimin dhe vrasjen masive në tërësi të popullatës shqiptare, e cila përbënte më tepër se 90% të popullatës së këtijë rajoni.
KFOR-it gradualisht po ia transferon obligimet policisë si dhe autoriteteve lokale të Kosovës. Në këtë forcë të KFOR-it marrin pjesë rreth 50.000 pjesëtarët e ardhur prej 39 shteteve të ndryshme të botës: disa nga pakti i NATO-së dhe disa të tjerë jashta paktit.
Për një funkcion më të mirë dhe më të lehtë, KFOR-it në Kosovë është i ndarë në 5 sektore:
Në sektorin amerikan të Lindjes me shtabin qendrorë në Kampin Bondsteel të Sojevës,
- Në sektorin Anglez me shtabin qendrorë në Prishtinë,
- Në sektorin Gjerman të Jugut me shtabin qendrorë në Prizren,
- Në sektorin Italian të Perëndimit me shtabin qendrorë në Pejë si dhe
- Në sektorin Francez të Veriut me shtabin qendrorë në Mitrovicë.

## RRUGËTIMI IM NGA AEROPORTI I RINASIT TË SHQIPËRISË PËR NË KOSOVË

*E Hënë, 14 Qershor 1999*

Pas zgjimit tonë në orën 10:00 para dite, patëm edhe takimin e fundit edhe me Gjeneralin Joe Hendrix në Shtabin e Përgjithshëm të Armatës Amerikane në Rinas të Shqipërisë, i cili na mbajti një fjalim para turmës së 40 ushtarakëve. Fjalimi në përgjithësi ishte faleminderues ndaj të gjithëve që ishim aty, si dhe për sukseset që arritëm së bashku me shtetet aleate të NATO-së dhe për ndihmën e Republikës së Shqipërisë si dhe për ndihmën nga njësitë e UÇK's.
Gjithashtu tregoi se dëshira e tijë personale kishte qenë që armikun jugosllav duhej shkatërruar tërësisht. Poashtu nuk e fshehi dëshirën e tij, e që ishte hyrja edhe e këmbësorisë ushtarake e NATO-së. Ai tha se do të ishte shumë mirë sikurëse të kishin marshuar deri në Beograd, atje ku edhe do ta kapte Presidentin e Jugosllavisë Milloshevigin, e që ta shqelmonte për të gjitha këto të zeza që i kishte sjellë popullit shqiptarë dhe të gjithë rajonit të ish Jugosllavisë!
Sipas fjalëve të tij, marrëveshja e nënshkruar në mes të NATO-së dhe Jugosllavisë ishte shumë pozitive, sepse gjerë më tani nuk kishim të humbur as një pjesëtarë ushtarak, përveçëse atyre të disa aksidenteve që kishin ndodhur gjatë kësajë kohe. Në fund të fjalimit, Gjenerali Hendrix na u faleminderua që të gjithëve për detyrën e kryer me shumë sukses, si dhe na dëshiroi kujdesë edhe më shumë suksese në punën e mëtejme tonën pasi se të shkojmë në mbrendësi të Kosovës. Pas përfundimit të fjalimit të Gjeneralit Hendrix, para se të niseshim nga Rinasi, që të gjithë kolegët që ishim nga grupi ynë, shkuam në zyret përkatëse që të kryenim punët tona personale që kishim.
Në orën 17:00 u mblodhëm që të gjithë pjesëtarët e Njësisë Speciale të Armatës Amerikane, dhe shkuam në pjesën tjetër drejtë aeroportit të Rinasit, aty afër pistës së fluturimeve, kudo të qëndronim për një kohë të shkurtë për t'u bërë gati deri në largimin tonë nga Shqipëria drejt vendit fqinjë Italisë, por kësajë here si triumfues.
Në orën 18:00 të mbrëmjes kaluam në anën tjetër të Aeroportit të Rinasit, në pistën kryesore ku po na priste një aeroplan transportues ushtarak C-17, me të cilin do të vazhdonim fluturimin drejtë për në aeroportin e Brindisit në Itali, dhe pastaj nga aeroporti do të kalonim aty afër për në bazën ushtarake amerikane të Brindizit.
Fluturimi ishte mjaftë i shkurtë, ku zgjati rreth 40 minutash për derisa kaluam në anën tjetër të detit Adriatik. Lartë nga ajri, gjatë largimit nga Shqipëria, pamë Alpet e larta me fushat e bukura për rreth, si dhe bregdetin e bukur shqiptar. Në të kaluar Detin Adriatik, tani në anën tjetër të detit na u paraqitë edhe pamja e bukur e qytetit të Brindisit i cili dukej mjaftë piktoresk nga ajri.
Nga aeroporti i Brindisit për në bazën ushtarake amerikane udhëtuam me një autobus ushtarak. Gjatë rrugës pamë bukuritë dhe pastërinë e këtijë qyteti bregdetarë të Italisë. Një ishte pastërtia diçka krejtë ndryshe nga ajo që i mungonte Shqipërisë, si dhe ato pamjet e dhimbshme me fabrikat e shkatërruara dhe pasurive shoqërore që ishin lënë pas dore...
Destinacioni ynë në Brindisi ishte baza ushtarake e Aviacionit Amerikan "San Vito Dei Normanni Air Station" e cila ishte 7 km. nga Aeroporti i Brindisit. Pas disa minutash arritëm mbrenda bazës ushtarake, ku më pas na dërguan në një godinë që më tepër i përngjante një konvikti studentor, ishte vendi ku do të qëndronim për disa ditë.
Personeli ushtarak që ishte aty, në të mbërrirë aty, secilit prej nesh na dhanë çarçafët dhe jastukët si edhe na caktuan dhomat e gjumit të cilat i përngjanin më tepër moteleve amerikane. Pas vendosjes aty menjëherë dolëm jashtë për të parë se ç'kishim për rreth mbrenda kësajë baze ushtarake. Aty afër pamë se kishim disa restorante dhe shitore që i përngjanin dhe ishin të njejta si plazat tregtare në Amerikë.
Krejtë në afërsi ku ishim vendosur kishim edhe antenën gjigante të përgjimeve, të cilën po e quanin Kafazi i Elefantit (Elephant Cage), e që dikur gjatë luftës së fohtë ky objekt përgjimi ishte shfrytëzuar për përgjime të bisedave, tetelefonatave dhe radio- lidhjeve të Paktit të Vërshavës (Rusisë)!
Tani me shkatërrimin e paktit të Vërshavës ky objekt thuajse kishte dalë jashtë përdorimit, dhe tani më tepër po i përngjante një ringu të cirkut!
Gjatë qëndrimit në këtë qytet në Jug të Italisë përballë bregdetit të Adriatikut, më risjelli përkujtimin e Gushtit 1991 të egzodit të dhjetëra mijërave refugjatëve të ikur nga shteti amë i Shqipërisë, e shumë prej tyre kishin ardhë dhe zbarkuar për rreth këtyre brigjeve, buzë këtijë bregdeti të bukur të Italisë!

→

Këta të rinjë kishin ardhë për të gjetë një jetë sa më të mirë, siç e provuam shumica prej nesh. Një histori prej shumë sosh,të dhimbshme të popullit tonë shqiptarë. Këtu krejtë afër qytetit të Brindizit, në rajonin e Puglias kemi edhe shumë vendbanime të vëllezërve tonë Arbëresh, siç janë vendbanimet: Apulia, Basilicata, Calabria, Campania, Molise e deri në jug në Sicili të cilët dhe zbarkuan po në të njejtat brigje, eksodet shqiptare të shekullit XVpara 500 vitesh. Po, menjëherë pas vdekjes se kryetrimit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti-Skenderbeu nga egërsia dhe rreziku i pushtimit Otoman.
Në Brindisi kaluam dy netë, ishte kënaqësi që tani pas afër tre muajsh fjetje në thesin ushtarak të gjumit, këtyre netëve këtu në Brindisi po bënim gjumin në shtretër normal, ku kushtet jetësore ishin shumë më të volitshme se sa i kishim patur gjerë më tani.
Ardhja jonë në këtë qytet të bukur bregdetarë për ne ishte edhe si një dhuratë e mirëseardhur, një pushim i shkurtër nga e gjithë ajo punë që patëm që nga shkuarja ime në bazën Amerikane në Rinas, e në veçanti nga arritja në Kukësin e bukur të Shqipërisë!
Të nesërmen me disa prej pjesëtarëve të grupit tonë i bëmë vizitë edhe në mbrendësi të këtijë objekti gjigant të përgjimeve, në Kafazin e Elefantit (Elephant Cage) një objekt ku ishin bërë përgjimet e telefonatave dhe radio lidhjeve të liderëve të ndryshëm komunist për dekada të tëra, qysh pas mbarimit të luftës së dytë botërore kur bëhet ftohja e marëdhënieve Lindje-Perëndim apo Komunizëm-Kapitalizëm!
Në Brindisi qëndruam deri të Enjten më 17 qershor 1999, atëherë kur na erdhi leja për të vazhduar udhëtimin tone drejt destinacionit tonë të fundit, destinacion që po e ëndërroja për muaj të tërë, për në Kosovën e Lirë!

***

*Informacionet e 24 orëve të fundit*

Sipas informacionit gjatë këtijë mëngjesi në Kosovë kishin hyrë 14,000 trupa paqëruajtëse të aleancës së NATO-së: 4,300 trupa britaneze, 2,800 franceze, 2,500 gjermane, 2,300 italiane edhe 2,100 amerikane, ndërsa kontingjenti amerikan prej 10,000 trupave pritet të kryhet mbrenda 30-45 ditët e ardhëshme, kurse nga Kosova deri më tani ishin tërhequr mbi 10,000 trupa jugosllave, dhe më tani gjithëçka po shkonte sipas planit të marrëveshjes.
Prezenca e 200 trupave ruse që kishin ardhë në Kosovë në mënyrë klandestine, të pa pritur dhe të cilët ishin vendosë tani në Aeroportin e Prishtinës kishte çfaqë telashe të mëdha, sepse kishin bllokuar trupat angleze dhe franceze që të themelojnë shtabin e tyre në atë hapësirë të aeroportit siç ishin marrë vesh.
Më 12 Qershor, nga SACEUR Gjenerali Clark këtë akt të shëmtuar rus e kishte kritikuar në mënyrë të ashpër, edhe tha se sipas rezolutës së OKB-së që ishte nënshkruar se si të udhëhiqen trupat paqëruajtëse kishte thënë: "Gjeneralin anglez Jackson, duhet t'i thotë trupave ruse që menjëherë duhet të largohen prej aty".
Më 13 qershor 1999 Gjenerali Clark tha se "Në këtë moment ky është problem politik" dhe se ky problem duhet të zgjidhet nga liderët politik.
Gjithëashtu edhe lëvizja e refugjatëve shqiptarë kosovarë sot ishte ndalë krejtësisht, kurëse autoritetet malazeze kishin lajmëruar se atje gjatë këtyre ditëve të fundit, deri më sot kishin arritur mbi 4,400 refugjatë dhe në përgjithësi të komunitetit serb që ishin larguar nga Kosova.

***

*E enjte 17 qershor 1999*

Njëri nga personeli i Njësisë së Forcave Speciale të grupit tonë, erdhi dhe ma bëri me dije që të bëhem gati sepse sot pas dite do të largohemi edhe nga kjo bazë ushtarake e Forcave Ajrore "San Vito dei Normanni Air Station" në Brindizi të Italisë.
Në orën 14:30 pas dite, përsëri u mblodhëm para godinës me plaçkat që kishim me vete aty ku kaluam dy netët e fundit, ku erdhi një autobus ushtarak dhe na mori të gjithëve, dhe vetëm pas disa minutash arritëm në aeroport, para një aeroplani ushtarak amerikan C-17 për të vazhduar udhëtimin më tutje.
Në orën 15:00 u nisëm me aeroplanin ushtarak C-17 në drejtim të Shkupit, për ku patëm një fluturim të rehatshëm, dhe ishim shumë të kënaqur se tani po iu afroheshim destinacionit të fundit për ku ishim nisë, ku tjetër pos në Kosovë. Fluturimi nga qyteti italian e deri në Shkup zgjati rreth 40 minuta.
Pas arritjes në aeroportin e Shkupit, prej dyerve të aeroportit erdhën dhe na morën dy autobusë ushtarak dhe na dërguan mbrenda në bazën ushtarake të NATO-së që gjendej në kandin tjetër të aeroportit. Me të arritur në bazën ushtarake na bënë regjistrimin e secilit prej nesh, dhe pastaj shkuam për të darkuar. Darka ishte mjaftë e mirë, shumë më mirë se siç ishim ushqyer deri më tani!
Pas darkës me dy autoblinda ushtarake Hamvee's, po të njejtit që i kishim pasë në Kukës të Shqipërisë e që ishin sjellë para nesh këtu në Shkup, grupi ynë u ndamë në dy makina dhe menjëherë vazhduam rrugën për në Kosovë.
Gjatë rrugës gjithëçka ishte në rregull. Autostrada në drejtim të Kosovës nëpër Elez Han ishte gati se e zbrazët, përveçëse diku diku që po hasnim në makinat e ndryshme ushtarake të NATO- së që gjithashtu po udhëtonin në të njejtin drejtim, drejtë në mbrendësi të Kosovës.
Kaluam rrugës nëpër Grykën e Kaçanikut, rrugë të cilën e kisha kaluar për shumë vite qyshë nga fillimi im në gjimnazin "Skenderbeu" në Kaçanik.Vend për të cilin kisha shumë kujtime të mira, aty ku kisha kaluar një pjesë të rinisë time, aty ku kalova dy vitet e para të gjimnazit para se të kthehemi në Kumanovë për të hapur gjimnazin Shqip. Vend ku edhe kisha shumë shokë dhe miq, si dhe vendlindja e Shahadijes, shoqes time të jetës!
Pastaj vazhduam rrugën nëpër Ferizaj dhe shkuam deri në afërsi të Prishtinës, aty ku ndahen arterjet e rrugëve kryesore për Gjilan dhe Prishtinë. Aty përsëri u kthyem në drejtim të Ferizajit. Në hyrje të Ferizajit kthyem majtas në drejtim të Gjilanit, dhe jo shumë largë,vetëmse pas disa kilometrash në afërsi të fshatit Sojevë. Dolëm nga rruga kryesore në krahun e majtë dhe shkuam në një shtëpi 3 katëshe të re e që gjendej krejtë afër rrugës e cila ishte ende pa përfunduar, pa dyer dhe pa dritare e që kishte një stil të veçantë, më tepër të lindjes së largët. Në bazë të mbeturinave që gjetëm në atë shtëpi, shifej se ajo shtëpi kishte qenë e shfrytëzuar edhe si strehimore për forcat e armikut serb. Meqenëse ishte vonë në mbrëmje, natën e parë mbrenda Kosovës e kaluam në mbrendësi të kësajë shtëpie, në dhomat e pa kryera të shtëpisë, pa dyer dhe dritare, në tokën e pa shtruar,vetëmse në thasët tonë të gjumit të shtruar në tokën e thatë.

***

*Informacionet e 24 orëve të fundit*

Sipas fjalëve të Lt. Gjeneralit Anglez Mike Jackson, ai tha se tërheqja e trupave jugosllave po lëvizte saktësisht sipas marrëveshjes, dhe deri më tani nga Kosova ishin tërhequr rreth 26,000 trupa prej gjithësej 40,000 trupave jugosllave që ishin, që na tregon se ata do të tërhiqen krejtësisht deri në ditën e paraparë më 20 qershor 1999. --- -Gjenerali Wesley Clark kishte dyshimin se ndoshta një numër i madhë i paramilitarëve serb do të mundohen që të infiltrohen dhe të mbesin mbrenda Kosove për t'i sjellë telashe trupave të KFOR'it.
Numri i trupave paqëruajtës të KFOR'it mbrenda Kosovës tani kishte arritur në 15,000 trupa: 7,209 trupa britaneze, 2,000 trupa amerikane, 1,747 trupa gjermane, 1,474 trupa franceze, 1,111 trupa italiane, 307 trupa kanadeze dhe 159 trupa daneze. Në vazhdim në Maqedoni ishin në pritje edhe 11,000 trupa shtesë të gatshëm për të hyrë në Kosovë.
Sot gjithëashtu kishim edhe viktimat e para të paqëruajtësve të KFOR-it nga kontingjenti italian kur dy ushtarët e tyre ishin lënduar nga minat.
Gjatë ditës së sotme në Shqipëri janë duke u zhvilluar bisedime në mes të përfaqësuesve të NATO- së dhe asajë të UÇK-së, për një marrëveshje të demilitarizimit të forcave të UÇK's, si dhe ushtrimin dhe inkuadrimin pjesëtarëve të sajë në forca policore civile. Ky plan parashef që mbrenda 30 ditësh pjesëtarët e UÇK-së të çarmatosen dhe të dorëzojnë armët e rënda si dhe ato automatike.
Sot gjithashtu në Helsinki kishin vazhduar bisedimet në mes të Ministrit të Punëve të Jashtme të Rusise Ivanovit dhe Sekretarit të Mbrojtjes së SHBA's Cohen, për marrëveshjen në lidhje me trupat ruse, që kishin okupuar aeroportin e Prishtinës.
Tani gjithashtu pritet që nesër të vijë në Kosovë edhe ekipa forenstike që përfaqëson krimet e luftës jugosllave për në tribunalin e Hagës, të cilët do të fillojnë me hetimet e varreve masive në Kosovë.



Në Prizren pjesëtarët e UÇK-së morën përsipër adminitratën e qytetit, pasi se u larguan autoritetet serbe. Kontingjenti Gjerman i KFOR'it në Prizren tha se nuk donë të ndërhyjë në marrjen në dorë të qytetit nga UÇK-ja.
Në të njejtën kohë nëpër shumë vende të Kosovës trupat paqëruajtëse kishin hasë në varret e shumëta masive të shkaktuara nga forcat jugosllave… Nga ana tjetër, që të gjitha rrugët ishin të nxanuna në të dy anët, në njërën anë prej kthimit të refugjatëve shqiptar në shtëpitë e tyre në Kosovë, e në anën tjetër të rrugës shifeshin duke u larguar refugjatët serb dhe rom, nga frika e ndonjë akcioni të hakmarrjes nga shqiptarët.
Sipas UNHCsë, mëse 6,500 shqiptarë etnik e lëshuan Maqedoninë për t'u kthyer në shtëpitë e tyre duke iu bashkuar edhe 3,400 refugjatëve të tjerë që veçëse ishin kthyer dje, edhe mëse 20,000 të tjerë që veçëse ishin larguar nga Shqipëria duke iu bashkangjitur edhe 15,000 refugjatëve nga dita e mëparme për në Kosovë.

## OPERACIONI I PËRBASHKËT KUJDESTAR (OPERATION JOINT GUARDIAN) (KFOR)

Operacioni i Forcave Aleate (Operation Alied Force) të NATO's përfundon me nënshkrimin e "Marrëveshjes Tekniko Ushtarake të Kumanovës", dhe pas nënshkrimit të "KAPITULIMIT" të forcave serbe dhe presidentit Sllobodan Milloshevig, pas përfundimit 78 ditorë të bombardimeve të NATO's, prej 11 Qershorit 1999 fillon etapa e re, e cila u emërua Task Forca Skifteri (Task Force Falcon). Dhe pas një kohe kjo forcë e KFOR-it përfundoi më 31 dhjetor 1999 kur fillon operacion i ri i quajtur Operacioni i Përbashkët Kujdestarë (Operation Joint Guardian).
Ky operacion kishte për detyrë ruajtjen e paqes në tërë Kosovën. Në këtë operacion do të angazhohet një personel prej 46,000 ushtarë, të ardhur prej 39 shteteve të ndryshme të botës, të cilët do të jenë që të gjithë nën të njejtën komandë, atë të NATO-së. Misioni i tyre ishte që të ndërtojë një vend të lirë dhe të sigurtë për të gjithë qytetarët e Kosovës pa marrë parasysh origjinën dhe etnitetit të tyre, dhe që duhej të jetojnë së bashku në paqë me ndihmën e ndër- kombëtarëve. Gjithashtu duhej që të zhvillohet edhe demokracia ndër këta popuj që ishin në konflikt qyshë me ardhjen në fuqi të Presidentit Serb Sllobodan Milloshevigit.
KFOR'i është forca e vetme paqëruajtëse ndër- kombëtare në Kosovë e udhëhequr nga NATO-ja, dhe që ka për qëllim zvogëlimin gradual të forcave të tyre për derisa përforcohen Forcat e Sigurisë së Kosovës e më vonë të shëndërrohen në Forca Ushatarake të Kosovës, për derisa të bëhen krejtësisht të pavarura...

*Vijon*




Sport


Veton Zymberi, redaktor i sportit

# Skitarja Sophie Sorschag pranoi dekretin shtetëror për ta përfaqësuar Kosovën




PRISHTINË, 3 PRILL - Skitarja e kërcimeve së larti, Sophie Sorschag, ka pranuar të hënën dekretin për dhënie të shtetësisë së Kosovës. Dekreti iu dorëzua nga presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK), Ismet Krasniqi dhe kryetari i Federatës Skitare të Kosovës (FSK), Milaim Kelmendi, njëherësh nënpresident i KOK-ut.

Presidenti Krasniqi falënderoi presidenten e shtetit, Vjosa Osmani, për lëshimin e dekretit dhe bashkëpunimin e frytshëm me KOK-un në mbështetje të sportistëve. "Do të kemi një sportiste të re të sporteve dimërore dhe kjo do të jetë risi, pasi është sport i veçantë, ku shumë pak shtete në botë kanë garuese të sportit të tillë. Sophia do ta përfaqësojë Kosovën në mënyrën më të mirë të mundshme. Presim rezultate si nga Kampionatet Botërore, ashtu edhe në Lojërat Olimpike Dimërore. Fokusi është 'Milano Cortina 2026'. Së shpejti ajo do të hyjë edhe në listën e bursave olimpike", ka thënë presidenti Krasniqi, duke shpresuar se në të ardhmen qeveria do të investojë edhe në infrastrukturën dimërore.

I pari i FSK-së, Kelmendi, theksoi se bëhet fjalë për një sportiste të nivelit botëror, e cila pritet t'i sjellë Kosovës medalje. "Faleminderit Sophies dhe ekipit të saj që kanë zgjedhur Kosovën. Shpresat janë të mëdha që ajo të na sjellë medalje nga gara të nivelit të lartë, e synimet e përbashkëta janë Lojërat Olimpike Dimërore", ka deklaruar presidenti Kelmendi.

Nga ana e saj, Sorschag u shpreh krenare që i është dhënë mundësia ta përfaqësojë Kosovën. "Është nder i madh për mua ta përfaqësoj Kosovën. Faleminderit KOK-ut, FSK-së, trajnerit, familjes time dhe gjithë atyre që e kanë bërë të mundur ta përfaqësoj Kosovën. Së bashku do të punojmë për të pasur një të ardhme të suksesshme", ka shtuar ajo.

Skitarja Sorschag, me prejardhje nga Austria, në janar të këtij viti vendosi ta përfaqësojë Kosovën në garat ndërkombëtare të kërcimeve me ski. Ajo është kampione e botës në ekipore me Austrinë në vitin 2021 si dhe pjesëmarrëse në Lojërat Olimpike Dimërore "Pekini 2022".

## SHKURT

### Zhegrova në formacionin e javës në Ligën 1

Reprezentuesi i Kosovës në futboll, Edon Zhegrova, ka shkëlqyer në fundjavën që shkoi në futbollin francez, duke i ndihmuar Lillet të shënojë fitore me rezultat 3-1 ndaj Lorientit pasi i realizoi dy gola për dy minuta në fund të takimit. Zhegrova u përfshi në ekipin ideal të xhiros së 29 të Ligës 1, duke qenë lojtari i dytë më i mirë i skuadrës me notën 9. Formacionet: Diouf, Diamande, Toure, Abdelhamid, Borges, Gomes, Cabella, Honorat, Zhegrova, Messi, Flips.

### Augsburgu do ta aktivizojë opsionin e blerjes së kartonit të Berishës

Augsburgu është i vendosur ta blejë kartonin e Mërgim Berishës. Shefi ekzekutiv i klubit gjerman, Stefan Reuter, ka bërë me dije se në fund të sezonit klubi do ta shfrytëzojë opsionin e blerjes së kartonit të Berishës për 4 milionë euro, shkruajnë mediet turke. Berisha aktualisht është i huazuar në Augsburg nga Fenerbahçe për një vit, pasi e pati një përvojë dëshpëruese në Turqi. Sulmuesi nga Kosova, pas rikthimit në futbollin gjerman, ka shpërthyer duke i realizuar 8 gola në 19 ndeshje të zhvilluara deri tash, të cilat e shpërblyen edhe me ftesën e Gjermanisë.

### CFR Cluj 'blindon' Krasniqin

Ish-lojtari i Ballkanit, Ermal Krasniqi, që po kalon nëpër një formë fantastike në skuadrën e CFR Cluj, ka marrë menjëherë oferta nga shumë skuadra, sidomos nga ato italiane, por aksionari i klubit rumun, Nelu Varga, nuk dëshiron ta shesë lojtarin. "Nuk e kemi marrë lojtarin për ta shitur pas katër apo pesë muajve. Ai mund të na ndihmojë të fitojmë shumë tituj", ka thënë Nelu Varga, një prej aksionarëve të Klubit nga Rumania. Krasniqi deri tani në ligë ka zhvilluar nëntë paraqitje, ka shënuar katër gola dhe ka bërë një asistim. Për ish-futbollistin e Ballkanit interesim kanë treguar disa klube italiane, përfshirë edhe Lazion.

## Gach, MVP i javës së fundit në elitën e basketbollit

Prishtinë, 3 prill - Fundjava dhuroi ndeshjet e fundit të garave të rregullta në elitën e basketbollit. Sigal Prishtina e përmbylli edicionin në vendin e parë, ndërsa fitorja e fundit ishte ndaj Ponte Prizrenit. Te prishtinasit më i miri ishte Both Gach me 22 pikë, nëntë kërcime dhe tetë asistime, duke u shpallur MVP i kësaj xhiro. Ai u ndihmua nga Rezart Memedi me 26 pikë, një kërcim dhe tri asistime. Memedi ishte i saktë tetë herë për tri pikë nga nëntë tentime. Golden Eagle Ylli i përmbylli me fitore garat e rregullta, duke mundur Bashkimin, kurse u dallua dyshja Demetris Morant dhe Henrik Sirko. Morant e përfundoi ndeshjen me dhjetë pikë, 20 kërcime e dy asistime, kurse Sirko me 28 pikë, katër kërcime e katër asistime. Trepça shënoi fitore të pritur kundër Vëllaznimit.



## Tucheli: Nuk e prisja telefonatën e Bayernit



MUNCHEN, 3 PRILL - Thomas Tuchel e nisi në mënyrë të mrekullueshme përvojën në krye të Bayern Munchenit, pasi e mposhti Borussia Dotrmundin (4-2) dhe rrëmbeu kreun në Bundesliga. Tucheli e ka pranuar se nuk ka pritur telefonatë nga klubi i "bavarezëve", por gjithçka ndodhi shumë shpejt. "Fillimisht u habita, nuk e prisja ta merrja detyrën e trajnerit në këtë periudhë. Kisha menduar për në verë, pasi nuk është se ndodhesha në bisedime me ndonjë ekip dhe kështu thashë të pushoj edhe për ca kohë. Më pas erdhi telefonata nga drejtuesit e 'bavarezëve' dhe gjithçka u mbyll në mënyrë rrufe. Derisa ju jeni duke bërë plane, jeta ju sjell befasi dhe ja ku jemi, teknik i një prej klubeve më të mëdha në botë. Ky është vetëm fillimi. Javë intensive na presin përpara", ka thënë Tuchel.

# Bujar Pllana, 'Ylli i javës' në Superligë




PRISHTINË, 3 PRILL - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin "Ylli i javës". Ky çmim për javën e 27 i ka takuar futbollistit të FC Prishtina, Bujar Pllana, i cili ishte më i miri i kësaj jave. Përveç se shënoi dy gola, ai kontribuoi edhe me një asistim në fitoren që bardhekaltrit e realizuan kundër Trepçës '89 (4-1). Ai, po ashtu, u vlerësua edhe për paraqitjen e mirë në mbrojtje, ku nuk pati asnjë gabim. Pllana u shpreh i lumtur për çmimin e fituar, por theksoi se në këtë edicion rëndësi kanë pikët për skuadrën, në mënyrë që sa më herët ta sigurojë mbetjen në Superligë. "Është nder dhe kënaqësi që të shpallesh më i miri i xhiros në Albi Mall Superligë. Ky çmim nuk do të ishte i mundur pa ndihmën e bashkëlojtarëve dhe trajnerëve, andaj i falënderoj shumë për mbështetjen. Kemi arritur t'i marrim 3 pikë shumë të rëndësishme për ecurinë e mëtutjeshme të kampionatit, duke synuar daljen në Evropë nga vendi i tretë. Atmosfera në ekip është shumë e mirë dhe shpresojmë të vazhdojmë me këtë ritëm dhe ta arrijmë objektivin e klubit, daljen në Evropë", ka theksuar Pllana për faqen zyrtare të FFK-së pas marrjes së çmimit.

# Rrezikojnë kampionët në fuqi, lakersat shumë afër 'play-off'

HOUSTON, 4 PRILL - Janë ndeshjet e fundit të sezonit të rregullt dhe skuadrat po bëjnë maksimumin për të hyrë në zonën "play-off". Kampionët në fuqi të Golden States po rrezikojnë të jenë mes gjashtë më të mirëve pas humbjes që pësuan në fushën e Denver Nuggetsit. Kryesuesit e Konferencës së Perëndimit fituan 112-110, duke lënë pas dy humbjet e fundit dhe mbajtur kreun. Ishte një përballje e ekuilibruar deri në fundin e saj. Edhe pse pa Jokiqin, skuadra vendase arriti të fitojë falë 29 pikëve të Porterit dhe 25 të Murrayt. Po në këtë konferencë erdhi fitorja e tretë radhazi për Los Angeles Lakersin, që mundi me rezultat 134-109 Houston Rocketsin jashtë fushës. Davisi me 40 pikë ishte lider në parket për kalifornianët, ndërsa LeBron Jamesi realizoi një "triple double", 18 pikë, 10 rebounde dhe 11 asistime. Në Lindje, në krye të renditjes, qëndron Milwaukee Bucksi, që mundi 117-104 Philadelphian, dy ekipe rivale në NBA. Maxey me 29 pikë e Embiidi me 28 nuk arritën t'i japin fitoren Philadelphias, ndërsa për Bucksin u dallua i zakonshmi Antetokounmpo me 33 pikë e 14 rebounde.




**REZULTATET**

| | |
|---|---|
| Charlotte - Toronto | 108-128 |
| Brooklyn - Utah Jazz | 111-110 |
| Chicago - Memphis | 128-107 |
| Minnesota - Portland | 105-107 |
| Atlanta - Dallas | 132-130 |
| New York - Washington | 118-109 |
| Orlando - Detroit | 128-102 |
| Sacramento - San Antonio | 134-142 |
| Houston - Lakers | 109-134 |
| Oklahoma - Phoenix | 118-128 |
| Cleveland - Indiana | 115-105 |
| Milwaukee - Philadelphia | 117-104 |
| Denver - Golden State | 112-110 |

## SHKURT

### Drita, kampione në Ligën e Parë

Me fitoren 41:36 ndaj Lepencit, Drita e Gjilanit ka përmbyllur një kampanjë shumë të suksesshme. Skuadra me traditë nga Gjilani ka fituar titullin e kampiones në Ligën e Parë të Kosovës në hendboll. Rinor Selmani udhëhoqi Dritën drejt fitores, duke i shënuar 16 gola. Tetë gola i shënoi Agim Isufi, ndërsa shtatë i realizoi Landrit Mustafi. Drita e Gjilanit i ka fituar të gjitha 14 ndeshjet dhe me pikë maksimale, 28, ka siguruar titullin e kampionit. Drita në edicionin e ardhshëm garon në Superligë. Pas Dritës renditen Samadrexha, Vjosa, Lepenci, Prizreni, Istogu, Ulpiana dhe Dukagjini.

### Pioli: Fitorja ndaj Napolit nuk ndryshon asgjë

Trajneri i AC Milanit, Stefano Pioli, ka thënë se fitorja ndaj Napolit (0-4) është vetëm një hap para, por nuk do të thotë asgjë për përballjen në Ligën e Kampionëve. "Fituam një ndeshje të rëndësishme, por është vetëm një hap përpara në këtë fund sezoni. Nuk duhet të kemi eufori. Ishte thjesht një paraqitje e mirë kundër një skuadre të madhe. Tani mendjen tek Empoli, pasi ndeshje të tilla na kanë penalizuar këtë sezon. Ky rezultat nuk do të thotë asgjë për përballjet në Ligën e Kampionëve. Do të jetë një tjetër ambient, tjetër situatë. Kjo fitore do të na japë mundësi ta studiojmë më mirë kundërshtarin, por nuk ndryshon asgjë", ka thënë Pioli.

### Spalletti: Liga e Kampionëve do t'i vendosë gjërat në vend

Trajneri Luciano Spalletti ka thënë se Napoli zhvilloi një paraqitje të dobët ndaj Milanit (0-4). Ai është optimist se në përballjen e Ligës së Kampionëve ndaj skuadrës kuqezi gjërat do të vendosen në vend. "Milani zhvilloi një paraqitje të madhe, shfrytëzuan çdo rast që u krijua. Ne luajtëm një ndeshje në nivel të ulët. Sfida në Ligën e Kampionëve? Nuk ndryshon asgjë, thjesht tani do të dalin disa persona që do të thonë se ne nuk jemi të avantazhuar. Ndeshja në Ligën e Kampionëve do t'i vendosë gjërat në vend", u shpreh Spalletti.

### Chelsea ka gjashtë opsione për postin e trajnerit

Chelsea e ka shkarkuar të dielën Graham Potterin, derisa tani është në kërkim të një trajneri të ri. Mediet në ishull raportojnë se në opsion të Chelseat janë gjashtë trajnerë. Bëhet fjalë për trajnerë të dëshmuar. I pari në listë është Julian Nagelsmann, i cili vetëm pak ditë më parë është shkarkuar befasisht nga Bayern Muncheni. Një tjetër emër është ish-trajneri i Real Madridit, Zinedine Zidane, por francezi është i lidhur edhe me skuadrën e PSG-së. Opsione të tjera janë Luis Enrique, Mauricio Pochettino, Antonio Conte dhe Hansi Flick.

## Joshua, mesazh Furyt: Koha s'kthehet më, le ta mbarojmë atë që nisëm vjet

Boksieri britanik Anthony Joshua u rikthye fitues në ring pas dy humbjesh dhe tashmë ëndërron që për të tretën herë në karrierën e tij të shpallet kampion botë. Ai ka shënjestruar patriotin e tij Tyson Fury për një duel, me shpresën që t'i rrëmbejë titullin kampion të kategorisë WBC. Dy ditë pas fitores ndaj Jermaine Franklin në Londër, ish-kampioni i botës u shpreh: "Unë e di se kë duan tifozët për duelin tim të radhës. Ai është Tyson Fury. Tashmë topi është në fushën e tij dhe të vendosë çfarë do të bëjë. Unë do të isha i nderuar të dueloja për titullin kampion të WBC".
Më tej, Joshua i çoi një mesazh Furyt: "Nëse Tysoni po më dëgjon, ai e njeh promovuesin tim dhe le të bisedojmë. Ne ka pasur dialog më parë mes nesh, kështu që le ta vazhdojmë atë që lamë në mes disa muaj më parë. Nuk po bëhemi më të rinj dhe koha kalon, ndaj le t'u japim fansave atë që duan".
Promotori Eddie Hearn mbështeti Joshuan në këtë kërkesë, duke shtuar: "Joshua dëshiron luftime më të mëdha. Kjo fitore ndaj Franklinit largoi presionet që kishte pas humbjeve me Usykun. Tani presim një reagim nga Fury. Jemi gati t'i rinisim bisedimet për një duel me Tyson Furyn këtë verë".

# Republika e Kosovës

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Qeveria –Vlada-Government*

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*

Në bazë të nenit 8, 67 dhe 68 të Ligjit nr. 06/L- 114 për Zyrtarët Publik, nenit 35 të Ligjit nr. 04/l-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe të Udhëzimit administrativ të MASHTI nr. 151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe të Zëvendësdrejtorit të Institucionit Publik Edukativo - Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Procedurat e Zgjedhjes dhe Emërimit, Përfundimit të Kontratës dhe Emërimit të Përkohshëm, MASHTI, shpall:

## K O N K U R S
## PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS

**Titulli i vendit të punës:** Drejtor/e në Qendrën Burimore për Mësim dhe Këshillim "Nëna Terezë" në Mitrovicë

**Institucioni:** Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
**Lloji i pozitës:** Nëpunës i Shërbimit Publik
**Titulli i mbikëqyrësit:** MASHTI
**Kohëzgjatja e emërimit:** Katër (4) vite

**Qëllimi i vendit të punës:** Udhëheqja, menaxhimi dhe mbikëqyrja e institucionit edukativo-arsimor.

### 1. Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publik:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotëroj njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas ligjit.

### 2. Detyrat kryesore të punës :

- Menaxhimi dhe administrimi i përgjithshëm i institucionit;
- Hartimi i planit vjetor të punës dhe planit zhvillimor të institucionit arsimor dhe raportet vjetore të punës;
- Përdorimi efikas dhe efektiv i sistemit për menaxhimin e informatave në arsim dhe respektimin e kodeve të këtij sistemi, procedurave të sigurimeve dhe afateve të përcaktuara për përditësimin e të dhënave të nevojshme gjatë vitit shkollor;
- Detyrat e caktuara për zgjedhjen e mësimdhënësve, vlerësimin, disiplinën në institucionin edukativo-arsimor dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësit dhe punëtorët tjerë në arsim;
- Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kurrikulës;
- Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e punës së aktiveve dhe bashkëpunëtorëve profesional të institucionit edukativo-arsimor, si dhe mekanizmave tjerë të institucionit arsimor që kanë rol në vlerësimin e performancës dhe menaxhimin e cilësisë së punës së institucionit;
- Bashkëpunimi me këshillin drejtues të institucionit edukativo- arsimor (KDSH),
- Këshillin e Prindërve, Këshillin e Arsimtarëve, Këshillin e Nxënësve dhe komunitetin e institucionit edukativo- arsimor;
- Raporton së paku dy herë në vit para KDSH;
- Siguron ambient të sigurt dhe përkrahës për fëmijët/nxënësit duke përfshirë edhe caktimin dhe aplikimin e masave disiplinore ndaj nxënësve, sipas legjislacionit në fuqi;
- Ruajtjen e dokumenteve dhe të dhënave, siç parashihet nga komuna apo Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI);
- Çështjet e tjera që rregullohen përmes ligjit për arsim parauniversitar, akteve nënligjore të miratuara nga MASHTI dhe obligimet që dalin nga rregulloret e QB.

### 3. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve:

- Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelit: Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (kualifikim prej 300 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit universitar);
- Master arsimor (kualifikimin prej 300 ECTS/5 vite të shkollimit universitar);
- Katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
- Bachelor katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
- Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësit;
- Të kenë përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të aprovuar nga MASHTI sipas rekomandimeve të KSHLM;
- Të ketë përvojë pune në procesin edukativo- arsimor sipas udhëzimeve të përcaktuara në katalogun e punës;
- Pesë (5) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për drejtor në arsimin e mesëm të lartë.

### 4. Kandidati duhet të posedoj dhe të dëshmoj dokumentet në vijim:

- Diplomat e fakultetit të kryer për nivelin përkatës të kualifikimit;
- Certifikatat për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë;
- Kandidati/ja që ka të përfunduar programin universitar Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, (në mungesë të certifikatës së trajnimit për udhëheqje në arsim kandidati/ja ofron dëshminë e diplomës Master për udhëheqje;
- Kopjen e dokumentit të identitetit (ID);
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar në gjashtë muajt e fundit nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
- Dëshminë se kandidati nuk është nën hetime dhe dëshminë se nuk ka qenë i/e dënuar për krim, dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët;
- Dëshmi të përvojës së punës në procesin edukativo- arsimor;
- Deklaratën në betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike;
- Portfolio profesionale me dëshmi sipas udhëzimeve në shtojcën/formularin H të UA, nr. 151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe të Zëvendësdrejtorit të Institucionit Publik Edukativo - Arsimor dhe Aftësues |Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Procedurat e Zgjedhjes dhe Emërimit, Përfundimit të Kontratës dhe Emërimit të Përkohshëm.
- Dokumentacioni i aplikimit përcaktohet më lartë, dorëzohet në kopje fizike në zyrën dhe afatin e përcaktuar në konkurs publik.
- Kandidati/ja në një konkurs publik ka të drejtë të aplikoj në një e më shumë shkolla. Në raste të tilla përgatit dokumentacion të ndarë për secilën shkollë ku aplikon.
- Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë të nostrifikuar diplomat nga MASHTI.

### 5. Informatat e përgjithshme

- 30 ditë nga dita e publikimit të konkursit mbetet vetëm njoftim, ndërsa konkursi mbetet i hapur 15 ditë, aplikacionet dorëzohen nga data 04.05.2023 deri me 18.05.2023.
- Formulari i aplikimit merret në Divizionin e Arsimit Gjithëpërfshirës /MASHTI
- Dokumentet duhet të jenë kopje (diploma e noterizuar) sepse ato nuk kthehen, ndërsa origjinali do të kërkohet me rastin e intervistimit
- Informata të sakta dhe të vërteta konsiderohen vetëm ato informata që dëshmohen me dokumente përkatëse ( jo ato që janë të deklaruara në aplikim)
- Kandidatët, dokumentet duhet ti dorëzojnë në arkivin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e pakompletuara nuk shqyrtohen (refuzohen).

**Informata shtesë**

Këto shtojca janë pjesë përbërëse e procesit përzgjedhës nga Komisioni i emëruar.

Shtojca 1 -Udhëzimi administrativ (MASH) NR.151/2020 për Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm.

Linku: https://masht.rks-gov.net/udhezim-administra-tiv-mash-nr-151-2020-per-de-tyra-t-dhe pergjegjesite-e-drejtorit-dhe-te-zevendesdrejtorit-te-institucionit-publik-edukativo-arsimor-dhe aftesues-parauniversitar-ne-republiken-e/

S dhe Shtojca 2 - Shtojcat e UA 151/2020 - dukë përfshirë Formularët të cilët janë kyç për përgatitjen e kandidatëve.

https://masht.rks-gov.net Shtojca-e-UA-151-1-formularët-për-vlerësimin-e-kandidatëve-për-drejtor-dhe-zëvendësdrejtor-të-iea.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria – Vlada – Government*

*Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit- Ministarstvo Obrazovanja Nauke Tehnologije i Inovacije- Ministry of Education, Science and Technology*

Na osnovu člana 8, 67 i 68 Zakona br. 06 / L-114 O javnim službenicima, član 35 Zakona br. 04 / l-032 o preduniverzitetskom obrazovanju u Republici Kosovo, i Administrativnog uputstva MONTI-a br. 151/2020 o dužnostima i odgovornostima direktora i zamenika direktora Javnih preduniverzitetskih edukativno-obrazovnih i osposbljavajućih institucija u Republici Kosovo, Procedure izbora i imenovanja, Završetak ugovora i Privremeno imenovanje, MONTI objavljuje:

## K O N K U R S

### ZA POPUNJAVANJE SLOBODNOG RADNOG MESTA

**Naziv radnog mesta:** Direktor/ca Resursnog centra za nastavu i savetovanje "Majka Tereza" u Mitrovica

**Institucija:** Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
**Vrsta pozicije:** Službenik javne službe
**Naziv nadzorom;** MONTI
**Period imenovanja:** Četiri (4) godine.

**Cilj radnog mesta:** Rukovođenje, menadžiranje i nadzor edukativno-obrazovne institucije.

1. **Opšti zahtevi za prijem javnih službenika**

- Da su državljani Republike Kosovo;
- Imaju punu sposobnost da deluje;
- Da govori jedna od službenih jezika, u skladu sa Zakonom o jezicima;
- Da je sposoban u zdravstvenom pogledu sposoban da izvrši odgovarajući zadatak;
- Da nije pravnosnažnom presudom kažnjavan za izvršeno krivično delo;
- Da nema disciplinsku meru koja je na snazi za razrešenje sa funkcije javnog službenika, razrešenog po zakonu.

2. **GLAVNI RADNI ZADACI**

- Opšte menadžiranje i upravljanje institucije;
- Izrada godišnjeg plana rada i razvojnog plana obrazovne institucije i godišnjih izveštaja o radu;
- Efikasno i efektivno korišćenje sistema za menadžiranje informacijama u obrazovanju i poštovanje kodeksa ovog sistema, procedura osiguranja i rokova za ažuriranje potrebnih podataka u toku školske godine;
- Zadaci određeni za izbor nastavnika, ocenjivanje, disciplina u Edukativno-obrazovnoj instituciji i druga pitanja u vezi sa nastavnicima i drugim radnicima u obrazovanju;
- Podrška i nadgledanje sprovođenje kurikuluma;
- Podržavanje i nadzor nad radom aktiva i stručnih saradnika u edukativno-obrazovno institucije, kao i drugih mehanizama obrazovne institucije koji imaju ulogu u vrednovanju performanse i menadžiranje kvalitet rada institucije;
- Sarađuje sa upravnim savetom edukativno-obrazovne institucije (ŠUO),
- Savet roditelja, Savet nastavnika, Savet učenika i zajednica edukativno-obrazovne institucije;
- Izveštava najmanje dva puta godišnje ispred ŠUO;
- Obezbeđuje bezbedno i podsticajno okruženje za decu / učenike, uključujući izricanje i primena disciplinskih mera prema učenicima, u skladu sa važećim zakonima;
- Očuvanje dokumenata i podataka, kao što je predviđeno od strane opštine ili Ministarstvo obrazovanja , nauke, tehnologije i inovacije (MONI);
- Ostala pitanja regulisana zakonom o preduniverzitetskom obrazovanju, podzakonskim aktima odobreno od strane MONTI-a i obaveze koje proizilaze iz pravilnika RC.

3. **Uslovi i kriterijumi za izbor kandidata:**

- Da ima završeno univerzitetsko obrazovanje nivoa: Master za rukovođenju administriranje ili menadžiranje u obrazovanju (kvalifikaciju od 300 ECTS najmanje 5 godina univerzitetskog obrazovanja);
- Master obrazovni (kvalifikacija od 300 ECTS / 5 godina univerzitetskog školovanja);
- Četiri godine (kvalifikacija 240 ECTS/4 godine univerzitetskog školovanja);
- Bachelor četverogodišnji (kvalifikacija 240 ECTS / 4 godine univerzitetskog obrazovanja)
- Da ima redovnu licencu za nastavnika u skladu sa uputstvom za licenciranje nastavnika;
- Da je uspešno završio akreditovani program profesionalne kvalifikacije za rukovođenje, administraciju ili menadžiranje u obrazovanje, zasnovan na standardima profesionalne prakse za direktore škola na Kosovu, odobrene od strane MONTI prema preporuka DSLN;
- Da ima radno iskustvo u edukativno-obrazovnom procesu prema smernicama navedenim u radnom katalogu:
- Pet (5) godine radnog iskustva u edukativno-obrazovnom procesu za kandidate za direktore u više srednje obrazovanje;

4. **Kandidat mora da poseduje i da dokaže sledeća dokumenta:**

- Diploma o završenom fakultetu za odgovarajući nivo kvalifikacije;
- Sertifikat o uspešnom završetku program treninga za rukovođenje, administriranje ili menađiranje u obrazovanju, zasnovano na standardima profesionalne prakse za direktore škola na Kosovu,
- Kandidat/kinja koji ima završen univerzitetski program Master za rukovođenje, administriranje ili menadžiranje u obrazovanju, (u nedostatku sertifikata o završenoj obuci za rukovođenje u obrazovanju kandidat/kinja, dostavlja kao dokaz diplomu Master rukovođenja.
- Kopija identifikacionog dokumenta (ID);
- Zdravstveni karton izdat poslednja šest meseca od strane određene licencirane
- zdravstvene institucije kojim dokazuje njegovo/njeno zdravstveno stanje;
- Dokaz da kandidat nije pod istragom i dokaz da nije osuđivan/a za zločine, nasilje ili nedostojna dela kojima su obuhvaćena deca;
- Dokaz o radnom iskustvu u edukativno-obrazovnom procesu;
- Izjava pod zakletvom kojom se potvrđuje da u poslednje tri godine kandidat nije bio ni na jednom rukovodećem mestu u strukturama političkih partija.
- Profesionalni portfolio sa dokazima prema uputstvima u prilogu / obrascu H, br. 151/2020 o dužnostima i odgovornostima direktora i zamenika direktora Javne edukativno-obrazovne i osposbljavajuće institucije u Republici Kosovo, Procedurama za izbor i imenovanje, Završetak ugovora i privremenom imenovanju.
- Dokumentacija za prijavljivanje je definisana gore, dostavlja se u štampanoj formi kancelariji u roku utvrđenom na javnom konkursu.
- Kandidat/kinja na javnom konkursu ima pravo da se aplicira u jednoj ili više škola. U takvim slučajevima priprema posebno odvojeno dokumentaciju za svaku školu u koju aplicira.
- Osobe koje su diplomirale van Kosova moraju da izvrše nostrifikaciju diplome u MONTI.

5. **Opšte informacije**

- 30 dana od dana objavljivanja konkursa ostaje samo obaveštenje, dok konkurs ostaje otvoren 15 dana, aplikacije se podnose od datum 04.05.2023 do 18.05.2023.
- Obrazac za prijavu dobijate u Diviziji za inkluzivno obrazovanje / MONTI
- Dokumenti moraju biti kopije (noterizovana fotokopija) jer se ne vraćaju, dok će original biti potreban tokom intervjua
- Tačne i istinite informacije smatraju se samo one informacije koje su dokazane relevantnim dokumentima (a ne oni koji su deklarisani u prijavi)
- Kandidati moraju dostaviti dokumenta u arhivi Ministarstva obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacije.
- Aplikacije dostavljene nakon navedenog roka neće biti prihvaćene, dok nepotpune aplikacije neće se razmatrati (biće odbijene).

**Dodatne informacije:**

Ovi prilozi su sastavni deo procesa izbora od strane imenovane Komisije.

1, Administrativno uputstvo(MASH) BR.151/2020 o zadacima i odgovornosti direktora i zamenika direktora javne preduniverzitetske edukativno-obrazovne i osposbljavajuće institucije, procedure izbora i imenovanja, završetak ugovora i privremeno imenovanje.

Link: https://masht.rks-gov.net/udhezim-administra-tiv-mash-nr-151-2020-per-de-tyra-t-dhe_pergjegjesite-e-drejtorit-dhe-te-zevendesdrejtorit-te-institucionit-publik-edukativo-arsimor-dhe_aftesues-parauniversitar-ne-republiken-e/

S i Prilog 2 – Prilozi AU 151/2020 – uključujući Obrasce koji su ključni za pripremu kandidata.

https://masht.rks-gov.net dodatak-au-151-1-obrasci-za-ocenjivanje-kandidata-za-direktora-i-zamenika-direktora-iea

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “BIKI 1985” SH.P.K. me pronar, Nderim Kurteshi Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811910480 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “BIKI 1985” D.O.O. Nderim Kurteshi Gjilan, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811910480 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “BIKI 1985” L.L.C. Nderim Kurteshi Gjilan, has come to the decision to quit its business: 811910480 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “MM 2023 CAFFE BAR” SH.P.K. pronar Rinor Hoxha-Alban Hoxha,Gjilan ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812007103 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “MM2023 CAFFE BAR” D.O.O. Rinor Hoxha-Alban Hoxha,Gjilan donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812007103 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “MM2023 CAFFE BAR” L.L.C. Rinor Hoxha-Alban Hoxha,Gjilan has come to the decision to quit its business: 812007103 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Full Moon Marketing”, Sh.P.K, ka marrë vendim të shuajë biznesin me NUI: 811944273 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë me këtë kompani që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Full Moon Marketing”, d.o.o., donelo odluku o prestani rada sa bisnisom NUI: 811944273 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

We inform all clients that “Full Moon Marketing”, L.L.C, has taken the decision to quit its business with NUI: 811944273, The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have creditor – debitor accounts with this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**Drejtoria e Gjimnazit “Remzi Ademaj” në Prizren**
**Nr.prot: 293/2023 datë 03.04.2023**

**Bazuar në nenin 11 të Udhëzimit Administrativ – Aktivitetet jashtëshkollore nr. 02/2016 të dt. 12.01.2016, vendimin nr. 192/2023 të datës 22.02.2023 nga KDSH, drejtoria e gjimnazit “Remzi Ademaj” në Prizren, Rishpall ftesë për ofertë:**

## Rishpallje e Ftesës për ofertë

**Për ekskursion të maturantëve të gjimnazit “Remzi Ademaj” në Prizren**

Ftojmë ofertuesit e kualifikuar (Agjencitë turistike organizatore të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarf të mbyllur, për ekskursionin e maturantëve të gjimnazit “Remzi Ademaj” nga Prizreni për në Republikën e Shqipërisë më datën: **08.05.2023** deri më **12.05.2023**.
***Paraqitësit në tender duhet t’i plotësojnë këto kushte:***

- Të jetë i licensuar (licenca e agjencisë turistike)
- Certifikata e agjencionit transportues
- Të ketë bërë kontrollin teknik sipas procedurave ligjore,
- Fotokopjet e librezave të autobusëve që janë të regjistruar sipas procedurave ligjore,
- Certifikata e autobusit sipas licencës D
- Licencën e transportit ndërkomëtar D
- Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës mbi 300 vende
- Autobusët të jenë komforë dhe me klimë,
- Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusit
- Agjencioni duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënësit dhe dëshmi, certifikatë pune me diplomë të mjekut që shoqëron nxënësit.
- Dëshmi për rezervimin e hotelit për datët 08.05.2023 deri më 12.05.2023.
- Agjencioni turistik duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve.
- Certifikatat e shoferëve (CPC)
- Referencat rreth organizmit të ekskursioneve me maturantë.
- Certifikatën e biznesit me informata për biznesin,
- Vërtetim për pagesën e tatimit në pronë
- Të prezentohet ambienti (komoditeti) së paku me foto i Hotelit nr.telefonit i pronarit dhe adresa të përcaktuar nga KDSH.
- Hoteli të posedojë mbi 300 shtretër. Të posedojë rrethojë dhe i siguruar nga personeli i sigurimit të hotelit për të garantuar siguri për nxënës përcaktuar nga KDSH.
- Hoteli të posedojë sallën e ushqimit me hapsirë të mjaftueshme mbi 300 vende për ushqim në tri vaktet kriter i përcaktuar nga KDSH.
- Hoteli të posedojë sallë për argëtim së paku për 300 nxënës dhe të mos shërbehen pije alkoolike për nxënës kriter i KDSH.
- Sistemimi i nxënësve në dhoma të jetë jo më shumë se katër nxënës përcaktuar nga KDSH.
- Gjatë vizitave nëpër monumente pagesa për nxënës të sigurohet nga kompania kriter i KDSH.
- Agjencioni duhet të ofrojë listën e shoferëve dhe punëtorëve që do të marrin pjesë në ekskursion kriter i KDSH.
- Agjencioni të ofrojë dëshmi për qarkullimin financiar nga banka për tre vitet e fundit, kriter i KDSH

Ofertuesit e interesuar aplikacionet dhe itinerarin e udhëtimeve mund t’i marrin në administratën e shkollës dhe të kompletuara me dokumentacionin e kërkuar të dorëzohen në Drejtorinë e Arsimit në Prizren.
Afati i paraqitjes në tender është 7 ditë nga dita e publikimit në gazetë.
Hapja e ofertave bëhet nga komisioni sipas UA 02/2016 me datë **12.04.2023 në ora 16:00** në ambientet e DKA Prizren ku mund të marrin pjesë edhe ofertuesit.
Pas hapjes se ofertave, Komisioni do të verifikojë dokumentacionin dhe kushtet e ofruara nga kopmanitë, ku dhe do të bëhet vlerësimi.
Fituesi i ofertës për organizimin e ekskursionit do të jetë kompania turistike e përgjegjshme me çmimin më të ulët të ofertës.
Drejtoria e shkollës mban të drejtën për anulimin e ofertës.

## Thirrje për aplikim

Halim Sinani B.I. – NUI **812016857**, me adresë në fshatin Barilevë, Rruga Mulla Ahmet Çunaku, 60, po kërkon ofertues/kontraktor/kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë ofertë/propozim për:

**“Ngritje të serës bllok 0.40 ha dhe energji efiqente (panele solare) 3 Kë”**

**Nr. Prokurimit Prill 01-2023.**

Emri: Halim Sinani B.I

Të interesuarit për aplikim dosjen me specifika mund ta kërkojnë përmes e-mailit: halimsinanih@gmail.com

Adresa: Fshatin Barilevë, Rruga Mulla Ahmet Çunaku, 60

Tel: +383 44 837 306

Ofertat duhen dorëzuar më së largu 15 ditë nga dita e publikimit ne gazetë të thirrjës**, ora 14:00**, në adresën e kompanisë: Fshatin Barilevë, Rruga Mulla Ahmet Çunaku, 60




RESTAURANT
SWISS
TAVERNA
Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
PRISHTINË




## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Artan Gurgushka shpall te pavlefshme 4 dëftesa, certifikatën , diplomën QK "11 Marsi " Prizren.

- Dani Francesk shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Zef Lush - Marku " Velezhe.

Valbon Gashi shpall te pavlefshme dëftesat QK "11 Marsi " Prizren.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
RC cola
0.5L


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues